



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 281 Akti

Nr. 362 Vendimi
Tiranë, më 31.3.2021

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Etleđa Çiftja	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kassler, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 9.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Genci Qana, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe dëgjoi në seancën dëgjimore z. Genci Qana, si dhe mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Z. Genci Qana, është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Genci Qana, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.1.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Etleđa Çiftja, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine (relatore).
3. Nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues, komisioneren Valbona Sanxhaktari dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Genci Qana, bazuar në tri kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 2.3.2021, brenda afatit të përcaktuar subjekti i rivlerësimit, z. Genci Qana, depozitoi shpjegimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës, të cilat u analizuan nga trupi gjykues.

7. Trupi gjykues, me vendimin nr. 3, ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Genci Qana, në seancën dëgjimore në datën 9.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

I. SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën 9.3.2021, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit, z. Genci Qana, edhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar në datën 12.3.2021, ora 10:00 me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

9. Në datën 9.3.2021, pas përfundimit të seancës, u dërgua një denoncim për subjektin e rivlerësimit, pas njohjes me të cilin, trupi gjykues vendosi të shtyjë diskutimet përfundimtare mbi vendimmarrjen dhe shpalljen e vendimit, për të kryer verifikimin e dosjes të referuar në këtë denoncim, për të vlerësuar nëse kishte të dhëna për të rihapur hetimin administrativ.

10. Pasi nga verifikimet mbi këtë denoncim nuk rezultuan *indicie* për rihapje hetimi, seanca vijoi në datë 31.03.2021 me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

11. Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksi, neni B, paragrafi 3, gërma "b", si dhe me ligjin nr. 84/2016, neni 49, paragrafi 11, vëzhguesi ndërkombëtar, z. Steven Kessler, i paraqiti trupit gjykues mendim bazuar në pikën 11, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

12. Trupi gjykues, administroi mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar i cili në referim të parashikimeve ligjore të pikës 11, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbënte përfundimin e arritur nga vëzhguesi ndërkombëtar për rrethana konkrete i cili mund të ndikonte në vendimmarrjen e Komisionit, por nuk kishte vlerën e provës.

12.1 Trupi gjykues vlerësoi ta referojë mendimin me shkrim të vëzhguesit ndërkombëtar në çështjet e përfshira në këtë mendim, për të arsyetuar se përse ky mendim nuk ndikoi vendimmarrjen e Komisionit në këtë rast.

A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm me konkluzionin se në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin e rivlerësimit, z. Genci Qana:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/1 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

14. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, nga ku ka rezultuar, si vijon:

1. Për pasurinë apartament banimi (1+1), me sipërfaqe 80.2 m², Tiranë

15. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë apartament banimi (1+1), me sip. 80.2 m², i ndodhur në adresën: rruga “****”, Tiranë, në vlerën 2.000.000 lekë. me burim krijimi të ardhura të përbashkëta me bashkëshorten.

16. Referuar DPV-së së vitit 2003, subjekti ka deklaruar pasurinë apartament banimi, me sip. 80.2 m² në bashkëpronësi me bashkëshorten, blerë në datën 16.2.2001, në vlerën 2.000.000 lekë, me burim krijimi kontributin e përbashkët me bashkëshorten nga të ardhurat për çdo vit.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

17. Nga hetimi i Komisionit, lidhur me këtë pasuri, ka rezultuar se është regjistruar në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes “apartamenti” me sip. 80.2 m², ndodhur në “****”, sipas çertifikatës së pronësisë¹ të datës 30.5.2006.

18. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se çmimi i blerjes së këtij apartamenti ka qenë 50% më i lirë krahasuar se çmimet mesatare të shitblerjes së apartamenteve në tregun e lirë të banesave për vitin 2001². Në lidhje me këtë konstatim, i pyetur nga Komisioni subjekti ka shpjeguar³ se: *“Për sa i takon çmimit të blerjes, sqaroj se ndonëse ky apartament është i regjistruar me një sipërfaqe prej 80.2 m², sipërfaqja e shfrytëzueshme e tij është rreth 71 m² dhe kjo mund të verifikohet lehtësisht duke kryer matjet fizike të apartamentit”*.

19. Si burim për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar kursimet, ndër vite, nga paga si hetues dhe OPGJ në hetuesinë dhe Prokurorinë e Rrethit Elbasan nga data 1.12.1988, dhe nga data 1.2.2000 si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Librazhd, ndërsa bashkëshortja të ardhurat nga paga pranë Ministrisë së Shëndetësisë, qendrës “****”, Tiranë, shoqatës “****”, dhe dhurata të dasmës.

20. Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar burimin e krijimit kontributin e përbashkët me bashkëshorten nga të ardhurat për çdo vit. Nga këto deklarime të burimit të krijimit, Komisioni konstatoi se në deklaratën *Vetting*, nga bashkëshortja e subjektit janë shtuar edhe të ardhura në formën dhurata të dasmës, të cilat nuk ishin pjesë e këtij burimi në DPV-në 2003.

21. Lidhur me burimin e të ardhurave të përfituara nga subjekti, Komisioni administroi dokumentacionin e dorëzuar në deklaratën *Vetting*, vërtetimet e të ardhurave nga punësimi i subjektit⁴ dhe bashkëshortes⁵, deklaruar burim për blerjen e apartamentit në shkurt të vitit 2001.

22. Në bazë të dokumentacionit të administruar dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni analizoi burimin e deklaruar të të ardhurave, për të evidentuar mundësinë e subjektit për blerjen e këtij apartamenti në shumën 2.000.000 lekë, krijimin/blerjen e pasurive të tjera, si dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1988 – 16.2.2001.

¹E ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së f. ***.

²Udhëzimi nr. 5, datë 31.5.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe koeficientin “k” (për Tiranën vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë për vitin 2001 është 56.306 lekë/m² sip. shfrytëzimi).

³Shihni përgjigje të pyetjes 5.1, të pyetsorit II.

⁴Vërtetim nr. ***/prot., E. Z. datë 24.10.2016, të Prokurorisë së Përgjithshme; shkresë nr. *** prot., datë 6.12.2016, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁵Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (Aneks ***, në dosjen e ILDKPKI): vërtetim datë 14.10.2016, lëshuar nga qendra “****” për periudhën nëntor 1998 – prill 1999 dhe maj 1999-dhjetor 2001; vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë Sigurimeve Shoqërore për znj. N. P. (Q.).

23. Në vlerësim të këtij dokumentacioni, Komisioni konstatoi se:

i) Për të ardhurat e bashkëshortes të përfituara nga paga në qendrën “****”, për periudhat nëntor 1998 – prill 1999, maj 1999 – dhjetor 2001 (deklaruar në deklaratën *Vetting* në vlerën 1.100.000 lekë), subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues të institucioneve shtetërore punësimin, kohën dhe vlerën e përfituar, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara.

ii) Për të ardhurat e bashkëshortes të përfituara nga paga në shoqatën “****”, për periudhën 1.4.1999 – 31.12.2000 (deklaruar në deklaratën *Vetting*, në vlerën 360.060 lekë), nuk provohet koha dhe shuma e saktë e deklaruar e përfituar, si dhe pagimi i detyrimeve përkatëse tatimore dhe sigurimeve shoqërore.

iii) Në bazë të shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2016, të Drejtorisë së Arkivit të Rajonit Tiranë⁶, datë 17.10.2016, të ardhurat e deklaruara mbi bazën e të cilave është derdhur kontribut në subjektin “****” fillojnë në tetor të vitit 2000 dhe për periudhën tetor – dhjetor të vitit 2000, këto të ardhura *bruto* rezultojnë në vlerën 51.480 lekë.

iv) Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie “*dhuratat e dasmës*” deklaruar nga personi i lidhur me subjektin në deklaratën *Vetting*, trupi gjykues vlerësoi të mos e përfshijë në analizë, si burim krijimi, për sa ky burim nuk është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003, deklaratë e cila shërben si provë për të rrëzuar pretendimet e subjektit për këto të ardhura.

v) Të ardhurat e dokumentuara⁷ të subjektit dhe bashkëshortes për periudhën 1988 – 16.2.2001, u llogariten referuar dokumentacionit ligjor provues në vlerën 2.293.524 lekë. Në DPV-në 2003, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit “Volkswagen Jetta”, në vitin 1998, në vlerë 200.000 lekë.

24. Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti deri në datën 16.2.2001, duke përllogaritur të ardhurat si më sipër si dhe shpenzimet jetike në vlerën 1.513.726 lekë (66% të të ardhurave⁸ familjare deri në datën 16.2.2001 të dokumentuara për subjektin dhe bashkëshorten). Në analizën financiare nuk u përfshinë shpenzime udhëtimi, qëndrimi, për periudhën që subjekti ka ushtruar detyrën në Elbasan dhe Librazhd, të ardhura, apo shpenzime, dhe krijim pasurish për/nga anëtarët e tjerë të familjes⁹ së subjektit.

25. Nga kjo analizë dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kryer për pasurinë apartament banimi me vendndodhje “****”, Tiranë, për blerjen e pasurisë së llojit autoveturë tip “Volkswagen Jetta”, në vitin 1998, dhe kryerjen e shpenzimeve për jetesë, duke rezultuar deri në datën 16.2.2001 me balancë negative në vlerën 1.420.202 lekë

25.1 Komisioni i kaloi subjektin barrën e provës, për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me këtë rezultat negativ financiar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

26. Në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, në lidhje me përllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve jetike për periudhën 1998 – 16.2.2001, subjekti ka kërkuar si vijon:

⁶Të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit si pjesë e dosjes *Vetting* pranë ILDKPKI-së.

⁷(i) të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1.12.1988 - 31.12.1994, janë llogaritur dhe pasqyruar në vlerën *bruto*, referuar shkresës nr. *** prot., datë 6.12.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe vërtetimit nr. *** /prot., E. Z., datë 24.10.2016, të Prokurorisë së Përgjithshme, ndërsa për periudhën 1.1.1995 - 16.2.2001, janë pasqyruar në të ardhura *neto* referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 20.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (ii) të ardhurat e personit të lidhur për periudhën nëntor, dhjetor 1998 në të cilën ka qenë e punësuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë, nga Komisioni janë marrë në konsideratë dhe pasqyruar në analizë të ardhurat *bruto*, sipas vërtetimit të lëshuar nga ISSH-ja, ndërsa të ardhurat e bashkëshortes për periudhën tetor 2000 - 16.2.2001, pranë qendrës “****”, janë vlerësuar të ardhurat sipas vërtetimit të lëshuar nga ISSH-ja; (iii) të ardhurat e personit të lidhur sipas vërtetimit nga qendra “****”, për periudhën nëntor 1998 – dhjetor 2001, nuk janë përfshirë në analizë financiare, për sa subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor provues të institucioneve kompetente shtetërore punësimin, kohën dhe vlerën e përfituar, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara.

⁸Vendim nr.18/2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁹Subjekti ka deklaruar se përpara blerjes së apartamentit në vitin 2001, ka jetuar së bashku me prindërit në shtëpinë e tyre.

*“Së pari, në analizë duhet që të përfshihen të ardhurat e bashkëshortes tek qendra ‘***’, Tiranë, për periudhën 1 nëntor 1998 deri në 16 shkurt 2001 dhe të ardhurat nga shoqata ‘***’ për periudhën 1.4.1999 deri në tetor 2000. Këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizë, pasi janë mbajtur në konsideratë vetëm të dhënat e përcjella nga ana e ISSH-së, në kushtet kur nga ana ime nuk ka qenë paraqitur ndonjë dokumentacion tjetër provues.*

*Së dyti, në analizë të përfshihen edhe të ardhurat e bashkëshortes të realizuara nga punësimi pranë shoqatës ‘***’ për periudhën nga prill 1999 deri në tetor 2000, për pagën mujore prej 17.160 lekë.*

*Së treti, shpenzimet e mia jetike në periudhën kohore deri më 31.12.2002, janë llogaritur gabim duke i konsideruar ato se janë në masën 66% të të ardhurave familjare, bazuar në vendimin nr. 18/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Kërkoj që Komisioni të mos bazohet në vendimin e sipërcituar të KPA-së dhe të kryejë përllogaritjet për shpenzimet e mia jetike (për periudhën deri në shkurt të vitit 2001), sipas metodologjisë të përdorur nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat e dërguara nga INSTAT (shkresa nr. *** prot., datë 13.2.2006, , si i vetmi institucion përgjegjës dhe i specializuar në Republikën e Shqipërisë për treguesit statistikor të konsumit vjetor dhe mujor për familje dhe frymë.*

Së katërti, shpenzimet jetike të bashkëshortes për sa unë dhe ajo kemi lidhur martesë ligjore më 6.9.2000 (kurorëzuar në kishë në datën 10.9.2000), përpara kësaj nuk kemi pasur asnjë jetesë ekonomike të përbashkët me njëri-tjetrin dhe bashkëshortja ka jetuar me familjen e origjinës”.

26.1. Subjekti ka depozituar si provë dokumentacionin si vijon: (1) kontratë pune, me palë punëdhënëse shoqata “***”, Tiranë, nënshkruar në datën 1.4.1999; (2) amendim i kontratës së punës në datën 1.5.1999; (3) shkresë “përshkrim pune”; (4) lista e pagave për periudhën janar – prill 1999, për subjektin “***”, me nr. regjistri ***, shoqëruar me 8 mandatarkëtime mod. ***, datë 12.8.1999, të Postës Shqiptare; (5) listëpagesa për periudhën gusht – tetor 1999 dhe janar – prill 2000, nga Associazione ***, Italia; (6) mandatarkëtimi nr. ***, datë 14.9.1999, i Bankës së Kursimeve nëpërmjet së cilit E. K. (***), ka paguar në favor të Biznesit të Madh Tiranë, shumën 123.967 lekë me përshkrimin “sa derdh fonde nga “***” për tatimet mbi të ardhurat janar-qershor Tiranë”, shoqëruar me një listë punonjësish; (7) listëpagesa e pagave për muajin gusht 1999 nga shoqata “***”; (8) listëpagesa për muajin shtator 1999 nga shoqata “***”; (9) listëpagesa për muajin tetor 1999 nga shoqata “***”; (10) listëpagesa për muajin janar 2000 nga shoqata “***”; (11) listëpagesa për muajin shkurt 2000 nga shoqata “***”; (12) listëpagesa për muajin mars 2000 nga shoqata “***”; (13) listëpagesa për muajin prill 2000 nga shoqata “***”; (14) deklaratë për kryerjen e pagesave nga shoqata “***”; (15) vërtetim, datë 25.2.2021, nga “***”, Tiranë; (16) fotokopje e njësuar e “Librezë Pune“, për znj. N. T. P..

Mendimi i vëzhguesit ndërkombëtar

27. Nuk ka asnjë arsye për të përjashtuar të ardhurat e bashkëshortes nga periudha 1998 – 2001, nga të dhënat financiare të subjektit të rivlerësimit. Kjo pasi vërtetimi i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit është më se i mjaftueshëm për mbërritjen në konkluzionin se këto fonde kanë qenë të ligjshme e të taksuara, si për periudhën e përmendur në mandatpagesën ashtu edhe për të gjitha periudhat e tjera kohore, pasi ka një tregues shumë të fortë se ajo ishte e punësuar në mënyrë të ligjshme dhe se detyrimet e saj tatimore ishin paguar plotësisht nga punëdhënësi.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

28. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, dhe në përgjigje të barrës së provës, dhe në seancën dëgjimore; si dhe (v) mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar arsyeton si vijon:

a) Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga shoqata “*”**

29. Në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të administruara, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes, trupi gjykues konstaton se rezultuan mospërputhje lidhur me të dhënat e pasqyruara në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës pas dërgimit të rezultateve të hetimit, me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit nga Komisioni si vijon:
30. Në bazë të kontratës së punës të datës 1.4.1999, e depozituar nga subjekti si provë, pala punëdhënëse është shoqata “****”, Tiranë. Subjekti ka paraqitur vërtetim nga qendra “****” Tiranë, në deklaratën *Vetting*, duke deklaruar se të ardhurat e bashkëshortes janë përfituar prej saj.
31. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura të përfituara nga shoqata “****”, për periudhën 1998 – 2001, por pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, subjekti ka depozituar dokumentacion për marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes në këtë shoqatë¹⁰.
32. Subjekti pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka depozituar edhe vërtetimin e datës 25.2.2021, të “****”, sipas të cilit kjo qendër për periudhën 1998 – 2001, ka qenë në varësi të shoqatës “****”, nga e cila janë mbartur detyrimet tatimore për këtë periudhë.
33. Komisioni vlerëson se ky vërtetim nuk justifikon mosdeklarimin e saktë në deklaratën *Vetting* të institucionit, entit apo shoqatës së saktë punëdhënëse, si dhe të ardhurave *neto* nga paga e bashkëshortes së subjektit në periudhën 1998 – 2001. Në bazë të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, në pikën 20, deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga pagat, duhet të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për të ardhurat *neto* nga institucioni pranë të cilit kanë qenë dhe janë të punësuar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë.
34. Referuar listëpagesave për periudhën janar – prill 1999, të shoqatës “****”, depozituar si provë nga subjekti, rezulton se nga kjo shoqatë janë deklaruar si të punësuar 2 punonjës me pagë 35.000 lekë/muaj, ndërsa referuar dokumentacionit, të dosjes së rivlerësimit, vërtetimi nga qendra “Strehëza për gra dhe vajza të dhunuara”, për të ardhurat e bashkëshortes se subjektit janë në vlerën 50.000 lekë/muaj (për periudhën nëntor 1998 – prill 1999).
35. Listëpagesat e dërguara, në të cilat bën pjesë si e punësuar edhe bashkëshortja e subjektit znj.N. P., përfshijnë periudhën janar – prill të vitit 1999, ndërsa referuar kontratës së punës marrëdhëniet e punës së bashkëshortes së subjektit kanë filluar në datën 15.3.1999.
36. Referuar provës sjellë nga subjekti i rivlerësimit, mandat-arkëtimit nr.***, datë 14.9.1999, të Bankës së Kursimeve, nëpërmjet së cilit znj. E. K., për llogari të qendrës ***, ka paguar në favor të Biznesit të Madh Tiranë, shumën 123.967 lekë me përshkrimin “*fonde nga ‘****’ për tatimet mbi të ardhurat janar-qershor Tiranë*”, shoqëruar me një listë emërore punonjësish, rezulton se ky dokumentacion vjen në kundërshtim me provën tjetër të dërguar, po nga vetë subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, listën e punonjësve të bashkëlidhur mandatarkëtimit të tatimit mbi të ardhurat në Bankën e Kursimeve rezultojnë 12+1 të punësuar, pa përcaktuar tatimin përkatës, ndërkohë që me listën e pagave të depozituara për periudhën janar – prill 1999, të shoqatës “****”, rezultojnë se janë vetëm dy punonjës të punësuar në këtë shoqatë me pagë *bruto* 35.000 lekë/muaj.
37. Gjithashtu, mandatet për pagesën e sigurimeve shoqërore në datën 12.8.1999, për 4 muaj, me 8 mandatarkëtime të Postës Shqiptare, rezultojnë se kane pasur urdhërues të veprimit punonjësit për sigurimet e tyre mujore dhe jo punëdhënësin/përfaqësuesin e shoqatës për shumën totale të sigurimeve mujore të këtij subjekti¹¹.

¹⁰Pasqyruar në paragrafin 17.21.

¹¹Referuar VKM-së nr. 112, datë 18.3.1999, “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994, “Për Sigurimet Shëndetësorë në Republikën Shqipërisë” pika II/iii/2, përcaktohet se: “Punëdhënësi bën sigurimin e personave të punësuar nga dita që punëmarrësi fillon punën me pagesë, mbështetur në një kontratë pune dhe e vazhdon atë gjatë gjithë kohës që punëmarrësi është në marrëdhënie pune”.

38. Mospërputhjet e të dhënave lidhur me të ardhurat e bashkëshortes, pasqyruar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës pas dërgimit të rezultateve të hetimit, krahasuar me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit nga Komisioni, cojnë trupin gjykues në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk mund të merret në konsideratë për sa vjen në kundërshtim me dokumentacionin e hetimit administrativ.

38.1 I vetmi dokumentacion ligjor i sjellë nga subjekti i rivlerësimit i cili nuk vinte në kundërshtim me të dhënat e hetimit ishte mandat-pagesa e Bankës së Kursimeve, për pagesë taksash në datë 14.2.1999, në shumën 124.340 lekë, për periudhën janar - qershor 1999.

39. Komisioni vlerësoi se subjekti ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues vetëm ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, duke provuar se për to janë paguar detyrimet tatimore ndaj dhe ato duhet të përfshihen në analizën financiare të ardhurat nga paga *neto*,¹² të bashkëshortes së subjektit për periudhën janar - prill 1999, nga punësimi pranë shoqatës “***”.

39.1 Trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga subjekti, për të ardhurat e pretenduara të përfituara nga paga e bashkëshortes para periudhës janar - prill 1999, nga puna në shoqatën Refleksione, jo vetëm ka mospërputhje por dhe nuk provon pagesën e detyrimeve tatimore, duke mos plotësuar kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ndaj dhe ato duhet të përfshihen në analizën financiare të ardhurat nga paga.

b) Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes nga Associazione ***, Italia

40. Trupi gjykues vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga subjekti, për të ardhura nga paga e bashkëshortes nga puna në shoqatën nuk plotësojnë parashikimet ligjore të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pasi:

- së pari këto të ardhura janë të padeklaruar në deklaratën *Vetting*;
- së dyti dokumentacioni i paraqitur në cilësinë e provës nuk vërteton ekzistencën e një marrëdhënieje punësimi midis bashkëshortes së tij dhe shoqatës “***” dhe nuk provojnë pagesën e detyrimeve tatimore, për këto të ardhura;
- së treti, përkundër pretendimit të subjektit se ka vend të zbatohet pika 2, e nenit 32, për dokumentacion të munguar, në dokumentacionin e sjellë, në asnjë nga shkresat, përfshirë ato të sjella nga subjekti apo ato të kërkuara në procesin e rivlerësimit, mungesa e dokumentacionit nuk i atribuohet kohës apo shkaqeve të tjera.

41. Trupi gjykues arriti në konkluzionin se të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga Associazione ***, Italia, nuk u arritën të provohen me dokumentacion ligjor provues, duke mos plotësuar kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ndaj dhe ato duhet të përfshihen në analizën financiare për të ardhura nga paga.

c) Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga shoqëria “”***

42. Komisioni në llogaritjet e të ardhurave nga paga në këtë shoqatë është bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 30.7.2020, të dërguar nga ISSh-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror, në të cilin deklarimi i të ardhurave dhe i kontributeve nga kjo shoqatë për bashkëshorten e subjektit fillon nga muaji tetor të vitit 2000.

43. Në lidhje me pretendimin e subjektit se bashkëshortja ka realizuar të ardhura në shoqatën “***”, duke filluar nga muaji prill i vitit 1999 me pagë 17.160 lekë/muaj, ky deklaram nuk rezultoi i provuar me asnjë dokumentacion ligjor, i cili të provonte se marrëdhënia e punësimit të bashkëshortes së subjektit kishte filluar përpara muajit tetor të vitit 2000. Gjithashtu nuk u provua me asnjë dokumentacion ligjor provues për këtë periudhë pagesa e detyrimeve tatimor, duke mos plotësuar kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

¹²Shumës të të ardhurave *bruto* sipas listës së pagave në vlerën 35.000 lekë/muaj zbritur kontributet të punëmarrësit dhe tatimi mbi të ardhurat sipas ligjit nr. 8438/1998.

44. Trupi gjykues, çmon të theksojë se nga dokumentacioni i sjellë nga subjekti, asnjë nga shkresat, përfshirë ato të sjella nga subjekti apo ato të kërkuara në procesin e rivlerësimit, mungesa e dokumentacionit nuk i atribuohet kohës apo shkaqeve të tjera.

45. Trupi gjykues arriti në perfundimin se të ardhurat e bashkëshortes nga shoqata *** përpara muajit tetor të vitit 2000, nuk u provuan me dokumentacion ligjor provues, duke mos plotësuar kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ndaj dhe ato duhet të përfshihen në analizën financiare për të ardhura nga paga.

d) Lidhur me shpenzimet e konsumit jetik

46. Në prapësimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se metodologjia e përdorur nga Komisioni në llogaritjen e këtyre shpenzimeve nuk përshtatet me qëndrimin e tij, ku shpenzimet jetike kanë qenë tërësisht individuale, të ndara nga prindërit, pjesë e një ekonomie tërësisht të ndarë prej tyre, si dhe duke kërkuar që Komisioni të mos bazohet në vendimin e Kolegjit dhe të kryejë përlllogaritjet për shpenzimeve jetike për periudhën deri në muajin shkurt të vitit 2001, sipas metodologjisë të përdorur nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat e dërguara me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2006, nga INSTAT.

47. Subjekti ka kryer analizë financiare nga viti 1995 – 16.2.2001, në të cilën për shpenzime jetike për të gjithë periudhën ka marrë për bazë shkresën e sipërpërmendur nga INSTAT.

48. Shpenzimet e konsumit jetik, deri në datën 16.2.2001, për efekt të analizës financiare, lidhur me mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortes për blerjen e apartamentit me vendndodhje “***”, Tiranë, janë përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave¹³ familjare.

49. Komisioni, në analizën financiare të dërguar subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ, ka përfshirë si pikë nisje fillestare deklarinë e subjektit lidhur me burimin në kohë të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, konkretisht nga viti 1988, ndërsa analiza e dërguar nga subjekti fillon në vitin 1995. Pra, nga subjekti janë hequr të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 1988 – 1995.

50. Dokumentacioni i referuar nga subjekti, lidhur me shpenzimet jetike sipas INSTAT¹⁴, nuk ka të dhëna statistikore në lidhje me konsumin vjetor dhe mujor për familje dhe për frymë përpara vitit 2000. Nga subjekti janë përfshirë në analizë shpenzime jetike 1995 – 1999, të cilat nuk kanë një bazë ligjore/statistikore apo metodikë llogaritjeje të miratuar/njohur.

51. Komisioni vlerëson se, shpenzime jetike të llogaritura prej tij, janë pasqyruar referuar një minimumi jetese, pa përfshirë shpenzime të udhëtimit, qëndrimit të subjektit për periudhën që ka ushtruar detyrën në Elbasan dhe Librazhd, si dhe pa përfshirë shpenzime karburanti, mirëmbajtje, taksa dhe të tjera, në lidhje me automjetin e blerë në vitin 1998, të ardhura, shpenzime, si dhe krijim pasurish për/nga anëtarët e tjerë të familjes¹⁵ së subjektit. Në analizë të pretendimeve dhe provave të dërguara nga subjekti, Komisioni vlerësoi që për periudhën 1988 -1999, shpenzimet e konsumit jetik të pasqyrohen në masën 66% të të ardhurave familjare, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, ndërsa për periudhën 1.1.2000 – 16.2.2001, të llogariten bazuar në shkresën nr. 42/1 prot., datë 13.2.2006, të INSTAT¹⁶.

52. Pas rishikimit të analizës financiare lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të cilat u provuan me dokumentacion ligjor për janar – prill 1999 dhe shpenzimet jetike, për periudhën 1.1.2000 – 16.2.2001, analiza perfundimtare financiare rezultoi si vijon:

Analiza financiare perfundimtare për periudhën 1988 – 16.2.2001	
Përshkrimi treguesve financiarë	Vlera në lekë
Të ardhura nga pagat, subjekti i rivlerësimit dokumentuar periudha 1988 – 1999	1.593.643
Të ardhura nga pagat, subjekti i rivlerësimit dokumentuar periudha 2000 – 16.2.2001	606.321

¹³Vendim nr. 18/2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 13.2.2006, e INSTAT me lëndë: “Kthim përgjigje –treguesit statistikorë të konsumit vjetor dhe mujor për familje dhe për frymë, 1993-2005”.

¹⁵Subjekti ka deklaruar se përpara blerjes së apartamentit në vitin 2001, ka jetuar së bashku me prindërit në shtëpinë e tyre

¹⁶Viti 2001 të merret si mesatare e vitit paraardhës me pasardhës.

Të ardhura nga paga e bashkëshortes në Ministrinë e Shëndetësisë dokumentuar viti 1998	16.340
Të ardhura nga paga e bashkëshortes shoqata “***” dokumentuar viti 1999	122.588
Të ardhura nga paga e bashkëshortes “***” dokumentuar 2000 –16.2.2001	77.220
Total të ardhura /të hyra financiare	2.416.112
Shpenzime minimale për konsum 66% të të ardhurave familjare periudha 1988 – 1999	1.143.497
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT për periudhën 2000 – 16.2.2001	241.992
Total shpenzime/të dala financiare	1.385.489
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Mjete monetare të disponueshme (1)	1.030.623
Blerje apartament në “***”, Tiranë në datën 16.2.2001	2.000.000
Blerje autoveturë tip “Volkswagen”, në vitin 1998	200.000
Detyrime	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	2.200.000
Balanca e fondeve (1-2)	-1.169.377

53. Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit rezulton në pamjaftueshmëri financiare prej -1.169.377 lekësh, për blerjen e kësaj pasurie, blerjen e autoveturës tip “Volkswagen” në vitin 1998, si dhe kryerjen e shpenzimeve minimale për konsum për këtë periudhë.

54. E vlerësuar kjo situatë negative financiare së bashku me faktin e rezultuar gjatë hetimit se vetë vlera e pasurisë apartament prej 2.000.000 lekësh ishte 50% më e vogël se çmimi mesatar i tregut të lirë, krijuan bindjen e trupit gjykues se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë financiare për blerjen e kësaj pasurie, parashikuar nga neni 33, pika 5“b”, e ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 84.4 m², Orikum, Vlorë

55. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi (1+1) me sipërfaqe të përgjithshme 84.4 m², i ndodhur në rruga “***”, Orikum. Çmimi 28.000 euro. Pjesa takuese 100%*”.

56. Nga hetimi i Komisionit konfirmohet regjistrimi i pasurisë në pronësi të subjektit. Në datën 13.11.2020, Komisioni ka kërkuar informacion në lidhje me origjinën e pronës Orikum, përfshirë dokumentacionin fillestar të regjistrimit dhe çdo ndryshim lidhur me këtë pasuri.

57. Në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë, Komisioni administroi kontratën e shitjes, datë 1.10.2011, të lidhur midis palës shitëse shoqërisë “***” sh.p.k. dhe blerësit Genci Qana.

58. Sipas kësaj kontrate, është përcaktuar se çmimi në shumën 28.000 euro, është shlyer nga palët. Komisioni ka pyetur subjektin në pyetësorin II, lidhur me kohën e shlyerjes, duke i kërkuar dokumentacion provues për kryerjen e pagesës.

59. Në përgjigje të pyetësorit II¹⁷, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës mandat-pagesën e datës 1.10.2011, për shlyerjen e shumës 28.000 euro.

60. Komisioni ka kërkuar informacion nga shoqëria “***” për mënyrën e pagesës, nga e cila u konfirmua se çmimi në zbatim të kontratës së shitjes, datë 1.10.2011, është paguar *cash*, pranë zyrave të shoqërisë në Orikum më 1.10.2011, sipas mandatit të datës 1.10.2011, në vlerën 28.000 euro, me përshkrimin “Genci Qana, për blerje apartamenti”.

61. Lidhur me çmimin e shitjes, Komisioni verifikoi kostot e ndërtimit dhe vlerat mesatare të shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2011 në qytetin e Orikumit, ku rezultoi se çmimi i shitblerjes në tregun e lirë ka qenë 57.000 lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi.

¹⁷ Përgjigje e pyetjes në pyetësorit 2, nr. 4.2

62. Duke vlerësuar mbi çmimin e referencës, rezultoi se çmimi që kanë deklaruar palët në kontratën e shitjes në vlerën 28.000 euro është më i ulët se vlera mesatare e shitblerjes së tregut të lirë të banesave në zonën e Orikumit, në një vlerë prej afro 1.000.000 lekësh.

63. Subjekti i pyetur lidhur me këtë konstatim, ka sqaruar se: *“Lidhur me këtë apartamenti, dua të sqaroj se sipas dokumenteve ai figuron me një sipërfaqe prej 84.4 m² por realisht sipërfaqja e shfrytëzueshme e tij është rreth 72 m. Nisur nga fakti që krahasimi bëhet me një vlerë mesatare, të përcaktuar mbi bazë formulash statistikore, diferenca prej 5.1 % e çmimit është normale, pasi ai është vendosur mbi rregullat e kërkesë/ofertës së tregut”.*

64. Lidhur me këtë çështje, subjekti ka kërkuar: *“Në këto rrethana, për të përcaktuar saktësisht sipërfaqen e shfrytëzueshme të këtij apartamenti kërkoj kryerjen e një ekspertimi mbi bazën e planimetrisë së apartamentit dhe për të konfirmuar shpjegimet të pyetet si dëshmitar shtetasi T. M., administratori i shoqërisë ‘***’ sh.p.k.”.*

65. Komisioni ka kërkuar informacion nëse rezultojnë të regjistruara procedime në prokuroritë ku ka punuar subjekti për të marrë konfirmimin nëse janë shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit procedime për shoqërinë “***” sh.p.k. apo shtetasve T. M. dhe B. M.. Nga përgjigjet nuk rezultuan të dhëna që lidhen me subjektin e rivlerësimit.

Analizë e burimit të deklaruar të ardhura për blerjen/krijimin e kësaj pasurie

66. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Apartament banimi në Orikum, i blerë me kontratën me nr. ***, datë 1.10.2011, përpiluar përpara noteres S. H., me të ardhura të krijuara nga kursimet familjare deri në atë kohë. Kursimet janë ruajtur në konvertuar në mënyrë sistematike për çdo vit nga lekë në euro, sipas kursit të kohës”.*

67. Referuar deklaramit për herë të parë dhe deklarimeve periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime në lidhje me shtesat dhe pakësimet, kursimet gjendje *cash* në banesë, si vijon: (i) në DPV/2003 (deklarimi për herë të parë), deklaroi gjendje *cash* në banesë shumën 600.000 lekë, me burim kursim nga të ardhurat e familjes ndër vite; (ii) në DPV/2004, nuk deklaroi shtesa dhe pakësime, kursime gjendje *cash*; (iii) në DPV/2005 deklaroi shtesë në *cash* shumën 600.000 lekë (**me korigjim**); (iv) në DPV/2006, deklaroi shtesë në *cash* në shumën 70.000 lekë nga shitja autoveturës regjistruar në emër të bashkëshortes, shtesë në gjendje *cash* nga kursimet në shumën 750.000 lekë; pakësim në gjendje *cash* të përdorura për blerjen e autoveturës tip “Peugeot 106”, në emër të bashkëshortes në shumën 320.000 lekë, në datën 21.2.2006; (v) në DPV/2007, deklaroi shtesë në *cash* nga kursimet në shumën 600.000 lekë (**me korigjim**); (vi) në DPV/2008, deklaroi shtesë në *cash* në shumën 600.000 lekë, me burim kursime; (vii) në DPV/2009, deklaroi shtesë në *cash* dhe llogarinë bankare të bashkëshortes pranë “ProCredit Bank”, vlerat 250.000 lekë dhe 4.000 euro, me burim krijimi kursime (*gjendja në llogarinë bankare nr.***, në euro, në emër të bashkëshortes në “ProCredit Bank”, në datën 31.12.2009, rezultoi në vlerën 3,426.7 euro dhe, për rrjedhojë, shtesa cash për vitin 2009 është llogaritur në shumën 250.000 lekë dhe 573 euro*); (viii) në DPV/2010, deklaroi: shtesë në *cash*, në llogarinë bankare nr. 26/01/00000200120, pranë “Credins Bank”, si dhe në llogarinë bankare personale të bashkëshortes pranë “ProCredit Bank”, vlerat 250.000 lekë dhe 6,000 euro, me burim krijimi kursime.

68. Gjendja në llogarinë bankare të subjektit në “Credins Bank” në datën 31.12.2010 ka qenë në shumën 101.648 lekë, në llogarinë bankare në euro, në emër të bashkëshortes në “ProCredit Bank” në datën 31.12.2010 rezultoi një vlerë 784.06 euro, ndërsa në llogarinë depozitë në euro në “ProCredit bank”, në emër të bashkëshortes rezultoi një gjendje prej 8.490 euro. Në total në llogaritë e bashkëshortes në “ProCredit Bank” në datën 31.12.2010, kanë qenë të depozituara në shumën prej 9.274,06 euro (ose shtesë nga viti i kaluar në shumën 5.847,36 euro) dhe, për rrjedhojë, shtesa *cash* për vitin 2010 është llogaritur në shumën 148.352 lekë dhe 153 euro.

69. Nëse do të konsiderohej se shumat e paguara për blerjen e pasurive të luajtshme autoveturë tip “Volkswagen Golf 3”, blerë në shumën 500.000 lekë, në datën 7.6.2004 dhe autoveturë tip “Fiat Panda”, blerë në shumën 70.000 lekë, në datën 11.12.2004, si dhe shpenzimet e deklaruara

për mobilim të apartamenteve në “***” dhe në rrugën “***”, për vitet 2003 – 2010, me burim të ardhurat e vitit përkatës, shuma e kursimeve *cash* të mbledhura deri në datën 31.12.2010, referuar deklarimeve do të rezultonte në vlerën 3.298.352 lekë dhe 726 euro.

70. Për sa i përket kursimeve të deklaruara, si shtesë të gjendjeve *cash* në vitin 2009 dhe 2010, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, ka rezultuar paraprakisht se viti 2009 dhe 2010 kanë balancë negative fondesh (përkatësisht -100.700 lekë dhe -95.934 lekë), si rrjedhim, duket se subjekti nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme për krijimin plotësisht të:

- shtesës në *cash* dhe llogarinë bankare të bashkëshortes pranë “ProCredit Bank”, vlerat 250.000 lekë dhe 4.000 euro, të deklaruar në DPV-në e vitit 2009 ; shtesën në *cash*, në llogarinë bankare nr. 26/01/00000200120, pranë “Credins Bank”, si dhe në llogarinë bankare personale të bashkëshortes pranë “ProCredit Bank”, vlerat 250.000 lekë dhe 6.000 euro, dekluar në DPV-në e vitit 2010.

71. Pra, mundësia në këto vite ka qenë për kursimin e një likuiditeti në vlerë -196.634 lekë, për rrjedhojë, për efekt të analizës së burimeve financiare për krijimin e pasurisë apartament, në Oriku, në vlerën 28.000 euro, në datën 1.10.2011, nga kursimet e mbledhura është zbritur shuma prej 196.634 lekësh.

72. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara/provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe informacioni/dokumentacioni i administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, u krye analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2011 – 1.10.2011, për blerjen e pasurisë së llojit apartament banimi në Oriku, Vlorë.

Analiza e treguesve financiarë periudha 01.01.2011-01.10.2011	
Përshkrimi	Vlera në Lek
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblime subjekti i rivlerësimit për periudhën	1.281.466
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblime bashkëshortja	0
Te ardhura interesa	4.347
Total të ardhura /të hyra financiare	1.285.813
Shpenzime për Vodafone transferuar nëpërmjet Credins Bank për periudhën	36.995
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI per periudhen	512.325
Total shpenzime/të dala financiare	549.320
Ndryshim mj.monetare <i>cash</i> deklaruar/llogaritur gj. fillim-gj. fund periudhe	3.202.465
Ndryshim mj.monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-87.588
Mjete monetare të disponueshme (1)	3.851.370
Blerje apartament në Oriku, Vlorë në datë 01.10.2011 për shumën 28.000 Eu	3.946.600
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	3.946.600
Balanca e fondeve (1-2)	-95.230

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit ju kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit për sa duket se, subjekti i rivlerësimit nuk ka patur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e apartamentit në Oriku Vlorë në datë 01.10.2011, në shumën 28.000 euro në vlerë- 95.230 lekë.

73. Nisur nga fakti që në DPV-në 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe shtesë të likuiditeteve gjendje *cash* dhe në llogarinë bankare të ndodhur pranë “Credins Bank”, shumën 250.000 lekë, si dhe shpenzime mobilim/arredimi, për apartamentin në Oriku, në vlerën 330.000 lekë¹⁸, u krye edhe analiza e treguesve financiarë për vitin e mbyllur 2011 (1.1.2011 – 31.12.2011), për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për këtë vit, konkretisht:

¹⁸ Përgjigje pyetësor nr. 2.

Analiza e treguesve financiarë periudha 1.1.2011 – 31.12.2011	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblime subjekti i rivlerësimit për periudhën	1.709.799
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblime bashkëshortja	0
Të ardhura interesa	4.347
Total të ardhura /të hyra financiare	1.714.146
Shpenzime mobilime ap. Orikum, deklaruar	330.000
Shpenzime për “Vodafone” transferuar nëpërmjet “Credins Bank” për periudhën	49.418
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, për periudhën.	683.100
Total shpenzime/të dala financiare	1.062.518
Ndryshim mj. monetare cash deklaruar/llogaritur gj. fillim-gj. fund periudhe	3.038.134
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-86.956
Mjete monetare të disponueshme (1)	3.602.806
Blerje apartament në Orikum, Vlorë, në datën 1.10.2011 për shumën 28.000 euro	3.946.600
Detyrime	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	3.946.600
Balanca e fondeve (1-2)	-343.794

74. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen/krijimin e pasurive të luajtshme, blerjen e apartamentit në Orikum, Vlorë, në datën 1.10.2011, në shumën 28.000 euro. si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2011 (balanca negative në vlerë -343.794 lekë).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

75. *Kërkoj që të ardhurat e bashkëshortes për vitet 2009 dhe 2010, të korrigjohen duke u pasqyruar të dhënat sipas derdhjeve që janë bërë në llogarinë e saj pranë ‘ProCredit Bank’ dhe pas këtij pasqyrimi të ribëhet analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2009 – 31.12.2009 dhe 1.1.2010 – 31.12.2010. Kalimi i pagave *neto* të bashkëshortes ka qenë në çdo muaj me dy transfertat, ku një nga transfertat është paga *neto* dhe transfertat tjetër është bonus që bashkëshortja ka marrë. Komisioni duhet të përlllogarisë si të ardhura për vitin 2009 dhe 2010, pagat e kredituara çdo muaj pranë bankës.*

76. *Referuar legjislacionit në fuqi, të cituar gjerësisht edhe më lartë, detyrimi për pagesën e detyrimeve tatimore është nga punëdhënësi. Bashkëshortja ime ka qenë në mirëbesim për pagesën e rregullt të detyrimeve tatimore. Paga është përfituar në bankë çdo muaj. Në përgjigjen e dhënë nga Drejtoria e Arkivit është dhënë informacion vetëm mbi pagën bruto që ka patur bashkëshortja në periudhën 2009 dhe 2010.*

77. Lidhur me gjendjen cash të deklaruar për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka shpjeguar sa vijon: *“realisht kursimet e mia kanë qenë ato në ato shifra siç ju kam shpjeguar përfshirë këtu edhe ato në atë deklaratën që ju thatë janë të korrigjuara. Unë i kam shpjeguar dhe realisht është një korrigjim mekanik nga nxitimi dhe ne vetëm një deklaratë dispononim atëherë, nuk kishim mundësi të.. nëqoftëse bënim një gabim material ta grisnim dhe të përdornim tjetër. Një na jepesh, ato janë korrigjuar, ju siguroj që thjesht janë korrigjuar për të treguar që kjo s’është por jo për t’u kujdesur që të maskohet. Këtë e them me përgjegjësi. Janë bërë në zyrën time dhe pa u dorëzuar deklarata, kjo është e sigurtë”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

78. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga

Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

79. Lidhur me pretendimin e subjektit mbi të ardhurat e bashkëshortes të transferuara në “ProCredit Bank”, të ardhurat e bashkëshortes për periudhën 2003 – 2010, janë pasqyruar referuar të dhënave nga Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2016, duke u reduktuar me pjesën takuese të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punëmarrësit, dhe tatimin mbi të ardhurat¹⁹ sipas legjislacionit përkatës.

a) Duke iu referuar analizës dhe dokumentacionit të dërguar nga subjekti, përshkrimi i kreditimeve bankare në llogarinë e bashkëshortes rezulton “për kalime page” duke mos mbështetur pretendimet e subjektit që këto kanë qenë shpërblime apo bonuse, kategori këto që nuk përjashtohen nga detyrimet e tatimit mbi të ardhurat sipas legjislacionit tatimor të kohës²⁰.

b) Nga subjekti nuk u dokumentua marrëdhënia kontraktuale, kushtet e punës/pagesës së bashkëshortes, për periudhën 2009 – 2010, me punëdhënësin si dhe nuk u depozitua dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave, për sa nuk u provua pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore për to.

80. Në lidhje me pretendimin e subjektit mbi të ardhura të bashkëshortes për vitin 2011, të cilat duhet të përfshiheshin në analizë nga verifikimi i deklaratimit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes në DPV-në e vitit 2011, nuk rezulton të jenë deklaruar në të të ardhura të përfituara nga bashkëshortja për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011. Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, deklarata e pasurisë për vitin 2011 është provë që rrëzon pretendimin e subjektit në lidhje me këto të ardhura ndaj ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare, pasi pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi të ardhura të përfituara nga bashkëshortja, për periudhën 1.1.2011– 31.12.2011, është i pambështetur në prova dhe ligj.

a) Lidhur me pretendimin e subjektit mbi gjendjet cash dhe këmbimin e vlerave monetare

81. Lidhur me pasqyrimin e gjendjeve *cash* në banesë, Komisioni i është referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratimet periodike përkatëse, jurisprudencës së Kolegjit²¹, përcaktimeve në legjislacionin përkatës²², si dhe dokumentacionit ligjor provues të burimit të deklaruar, mundësisë financiare për krijimin e tyre dhe destinacionin e tyre.

a) Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklaratimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhin mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor.

b) Forma e deklaratimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar. Në këndvështrim të kuadrit ligjor, subjekti ka detyrë të deklarojë duke pasqyruar një fotografi të interesave të tij pasurorë e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, qëndrim i analizuar edhe me jurisprudencën e Kolegjit²³.

82. Komisioni, pasi analizoi deklaratimet periodike të subjektit vëren se nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti kryerja e këmbimit të shumës *cash* të përdorur për burim krijimi nga lekë në monedhë euro në vite të ndryshme, ndërsa për sa i përket ndryshimeve/gjendjeve të llogarive bankare në euro, subjekti i ka deklaruar ato në DPV-të përkatëse.

83. Argumentet e dhëna nga subjekti nuk duken bindëse për Komisionin, pasi deklarimi periodik është pasqyrimi i gjendjes reale të kursimeve *cash* në fund të viti në lekë apo euro, i krahasuar

¹⁹ Aneks, shpjegime të analizës së treguesve financiarë.

²⁰ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

²¹ Referuar Jurisprudencës së Kolegjit (vendim nr. 29/2019, nr. 11/2019).

²² Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

²³ Vendim nr. 20/2019, i Kolegjit, parag.54-59.

apo vlerësuar me gjendjen në vitin paraardhës dhe jo analizë matematikore siç pretendohet nga subjekti.

b) Lidhur me kursimet cash deklaruar në vitin 2005 dhe 2007

84. Lidhur me kursimet *cash* deklaruar në vitin 2005 dhe 2007, të cilat rezultuan me korigjime, që dukshëm binin në sy me një vështrim të zakonshëm, përdorur për pagimin e vlerës *cash* nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, trupi gjykues nuk i gjen bindëse e të mbështetura në legjislacionin në fuqi shpjegimet e subjektit mbi korigjimet e arsytet e korigjimit të tyre në vitet 2005-2007.

85. Ato konsiderohen si pasaktësi në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me gjendjen *cash* dhe çojnë trupin gjykues në përfundimin se në këtë rast deklarimi i subjektit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “a” dhe nenit 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016.

3. Autoveturë tip “Ford Fokus C-Max”

86. Në *Vetting*, subjekti deklaroi: “*Autoveturë Ford Fokus C-Max, vlera 14.900 euro*”. Subjekti ka deklaruar se për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer si burim:

- i) të ardhura familjare të krijuara pas datës 1.10.2011 dhe përgjatë vitit 2012;
- ii) shitja e autoveturës, tip “GOLF 3”, me targa ***, në shumën 1.000 euro;
- iii) dhuratë në shumën 4.000 USD nga vjehri;
- iv) hua pa interes në shumën 5.000 euro, marrë te një shok.

87. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “*Shtesë në pasuri të luajtshme, një autoveturë të markës ‘Ford modeli Fokus C-Maks’, blerë në datën 10.12.2012, te shoqëria ‘***’ burimi i krijimit, blerë me të ardhurat të krijuara nga kursimet e vitit 2011 dhe 2012, dhuratën prej 4.000 USD të vjehrit, si dhe të një huaje pa interes në shumën 5.000 euro*”.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

88. Komisioni administroi si dokumentacion faturë tatimore shitje, datë 11.12.2012, lëshuar nga shoqëria “****”, me vlerë 14.900 euro.

89. Referuar nenit 10 të kontratës së shitblerjes palët kanë dakordësuar se çmimi do të likuidohet në llogari të shitësit para dorëzimit të mjetit.

90. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime, i cili përgjigje të pyetësorit II, ka sqaruar se: “*Pagesa për blerjen e automjetit është kryer pranë ‘Credins Bank’, në datën 11.12.2012*”, duke paraqitur në cilësinë e provës mandatpagesën²⁴ *cash* në llogarinë e palës shitëse shoqërisë “****”, në datë 11.12.2012, në shumën 14.900 euro.

Analiza e burimeve të krijimit

i) Të ardhura familjare të krijuara pas datës 1.10.2011 dhe përgjatë vitit 2012

91. Në DPV-në e vitit 2011, në ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Shtesë në para cash dhe në llogarinë bankare të ndodhur pranë ‘Credins Bank’, në shumën 250.000 lekë*”.

92. Referuar dokumentacionit të disponuar dhe deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit u krye analiza e treguesve financiarë, për periudhën 1.10.2011– 31.12.2011, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, për krijimin e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve, nga ku rezultoi se subjekti ishte në pamundësi financiare për krijimin e shtesës së gjendjes *cash* të deklaruar në shumën 164.331 lekë dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.10.2011 –

²⁴ Mandatpagesë paraqitur në pyetësorit II, në “Credins Bank”, datë 11.12.2012, shuma 14,900 euro në favor të shoqërisë “****” me përshkrim “arkëtim blerje makine FORD CMAX GENCI QANA”

31.12.2011, duke rezultuar me një balancë negative në shumën prej 268.772 lekësh. Për rrjedhojë, ky burim i deklaruar nuk u përfshi në analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie.

93. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e shtesës së gjendjes *cash* të deklaruar në shumën 164.331 lekë dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.10.2011 – 31.12.2011. Për rrjedhojë, ky burim i deklaruar nuk u përfshi në analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie.

ii) Shitja e autoveturës tip “GOLF 3”, me targa *, në shumën 1.000 euro**

94. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “*Para cash të fituara nga shitja e një autoveture tip ‘GOLF 3’ shitur shtetasit Uran Hajdari me kontratën nr. ***, datë 7.11.2012, shuma 1,000 euro*”.

Për rrjedhojë, ky burim i të ardhurave i deklaruar është përfshirë në analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie.

iii) Dhurata nga babai i bashkëshortes së subjektit, në shumën 4.000 USD

95. Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e deklaruesit, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, rezultoi të ketë konfirmuar këtë marrëdhënie të dhurimit jo vetëm në deklaratën *Vetting*, por edhe në deklarinimin periodik të pasurisë në vitin 2012.

96. Në zbatim të kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues, ndodhur para një marrëdhënie të konfirmuar të dhurimit, i kërkoi subjekti i rivlerësimit të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhuruar, në shumën 4.000 USD, nga babai i bashkëshortes.

97. Ka rezultuar se në llogarinë pranë “Tirana Bank” të shtetasit T. P., për periudhën 12.3.2012 – 3.12.2012, është kredituar pagesa 900 USD me përshkrimin “*From D. J. A. Ch. paradhënie qiraja garanci*” dhe shuma 450 USD/muaj me përshkrimin “*Rent from d3 applied ethics*” në shumë totale prej 4.950 USD, nga të cilat në datën 7.12.2012 janë tërhequr *cash* 4.000 USD nga llogaria e tij.

98. Komisioni administroi kontratën e qirasë me objekt dhënien me qira të një ambienti me sip. 104.72 m², në rrugën “****”, me afat 4-vjeçar, sipas së cilës qiradhënësi e zotëron në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 15.6.2006. Qiraja është përcaktuar në vlerën 450 USD/muaj dhe do të paguhej në llogarinë bankare të qiradhënësit, i cili do të paguante edhe detyrimet fiskale.

99. Në kuptim të analizës financiare ky burim u konsiderua në analizën financiare të vitit 2012, duke iu kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion ligjor provues se parashikimet ligjore në kontratën e qirasë janë ndryshuar për pagesën e tatimit, i cili do kryhej nga qiramarrësi.

iv) Hua pa interes në shumën 5.000 euro, të marrë te një shok

100. Në DPV-në e vitit 2012, seksioni “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “*Huamarrje pa interes në shumën 5.000 euro nga shtetasit Z. S. D. i datëlindjes 5.3.1965, lindur në Berat dhe banues në rr. ‘***’, Tiranë*”, pa kontratë noteriale”.

101. Deklarata noteriale e datës 29.10.2016, e lëshuar nga shtetasi Z. D., konfirmon se: “*Unë Z. D. deklaroj se në datën 10.12.2012 i kam dhënë shokut tim Genci Qana i biri i A. dhe i Zh. i datëlindjes 4.4.1965, një hua në shumën 5.000 euro me qëllim blerjen e një automjeti të markës FORD*”.

102. Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e deklaruesit sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, rezultoi të ketë konfirmuar këtë marrëdhënie të huas në deklaratën *Vetting* edhe në deklarinimin periodik të pasurisë në vitin 2012.

103. Në zbatim të kërkesave të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues, ndodhur para një

marrëdhënie të konfirmuar të huas, i kërkoi subjekti i rivlerësimit të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhënë hua.

104. Pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, Komisioni vlerësoi se ka mospërputhje të informacionit të dhënë nga organi tatimor me atë të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me tatimin mbi qiranë të paguar.

105. Komisioni, në shqyrtim të dokumentacionit të administruar, vlerëson se nuk është dokumentuar vlera e përfituar nga qiratë, koha e përfitimit, tatimi përkatës i paguar, si dhe mundësia financiare e huadhënësit për të përballuar shpenzimet për jetesë, pa marrë në konsideratë edhe investime të kryera në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme²⁵ gjatë kësaj periudhë, prandaj në analizën financiare ky burim nuk është marrë në konsideratë. Për rrjedhojë, ky burim i të ardhurave nuk është përfshirë në analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie.

v) Të dhënat e rezultuara nga “Credins Bank”

106. Në datën 18.12.2012, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* nga llogaria e tij e pagës shumë 580.000 lekë, ndërsa bashkëshortja në datat 20.12.2012, 24.12.2012 dhe 26.12.2012 ka tërhequr *cash* nga llogaria e saj në këtë bankë shumë totale prej 150.000 lekësh. Në lidhje me destinacionin e shumave të sipërcituara, në vlerësim të faktit edhe se në DPV-në e vitit 2012 nuk janë deklaruar shtesa të vlerave monetare *cash* në banesë, por vetëm pakësim të tyre, iu kërkua subjektit të deklarojë se cili ka qenë destinacioni i shumës prej 730.000 lekësh më sipër.

107. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4²⁶, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“...destinacioni kryesor i shumës totale prej 730.000 (rreth 695.000) lekësh ka qenë rimbursimi i një shume prej 5.000 euro, që me kërkesën time, shoku im i quajtur E. V. m’i kishte dhënë për përdorim të përkohshëm në datën 11.12.2012, pasi atë ditë jam ndodhur në një situatë të ngutshme për kryerjen e pagesës për autoveturën e markës ‘Ford, me targa *** FI. Rimbursimi është realizuar në dy-tre ditët e fundit të vitit, në monedhën euro, mbas konvertimit në ‘change’ të sasisë së lekëve të tërhequra nga dy llogaritë bankare (imja dhe e bashkëshortes). Kështu që, përfundimisht mbas këtij veprimi (rimbursimit të shumës prej 5.000 euro të marrë në datën 11.12.2012), rezulton që destinacioni i shumës prej rreth 695.000 lekësh ka qenë për blerjen e autoveturës në fjalë. Ndërsa, shuma e mbetur (35.000 lekë) nga shuma totale prej 730.000 lekësh ka pasur si destinacion pagimin e siguracionit të automjetit dhe plotësimin e shpenzimeve të zakonshme të muajit dhjetor 2012. Duke bashkëlidhur deklaratë noteriale të shtetasit E. V., me nr. ***, datë 25.1.2021”*.

108. Për sa më sipër, subjekti si burim të krijimit/blerjes së pasurisë autoveturë tip “Ford”, modeli Focus, shton edhe shumë prej 5.000 euro, e cila është deklaruar si e dhënë në përdorim nga shtetasi E. V..

109. Nisur nga fakti që burimi i mësipërm (shoqëruar me deklaratën noteriale të datës 25.1.2021) nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2012, por është deklaruar vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit²⁷, nga Komisioni u vlerësua se ky burim nuk mund të merret në konsideratë, duke mos e përfshihet në analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie, ndërsa për sa i përket shumës prej 730.000 lekësh ajo u pasqyrua si shpenzim për periudhën 18.12.2012 – 31.12.2012.

110. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara/provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë, për periudhën 1.1.2012 – 11.12.2012,

²⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka dërguar, ndërmjet të tjera, edhe një mandatarkëtimin në llogari të shoqërisë “****”, në “Credins Bank”, të shumës prej 13.200 euro, në datën 14.1.2012, me përshkrim “likuidim makine tip “ Ford Focus” Z. D.”.

²⁶Përgjigje e pyetjes nr. 4, dërguar në datën 25.1.2021.

²⁷Vendimet nr. 6/2018, datë 12.9.2018, parag. 35 dhe 36; nr. 34/2019, datë 2.12.2019, parag. 85.2; nr. 2/2020, datë 27.2.2020, parag.20.5.

për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, për blerjen e pasurisë autoveturë tip “Ford”, modeli Focus C-Max.

111. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e autoveturës tip “Ford Focus” në datën 11.12.2012, në shumën 14.900 euro, shtesën në likuiditete bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2012 – 11.12.2012 (balanca negative e llogaritur në vlerën -1.748.372 lekë).

112. Gjithashtu, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se ka mospërputhje të deklaratës *Vetting* dhe deklarimit periodik me ato gjatë procesit administrativ, në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie dhe subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* huan e marrë nga shtetasi E. V., si burim për këtë pasuri.

113. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet dhe ka depozituar prova, duke kërkuar që në analizën e treguesve financiarë të vitit 2012:

- shuma prej 730.000 lekësh të mos konsiderohet shpenzim për periudhën 18.12.2012 – 31.12.2012; por të merret në konsideratë dhe përfshihet në analizë si burim i blerjes së autoveturës tip “Ford”;
- shuma prej 1.299 euro (181.327 lekë) të zbritet nga shpenzimet e qëndrimit një javor në Korfuz, pasi është paguar nga shoku i tij;
- huaja prej 5000 euro marrë shokut tim Z. D. të merret në konsideratë dhe të përfshihet në analizë;
- shuma prej 4.000 USD dhuratë nga vjehri T. P., të konsiderohet pa rezervë në analizën financiare.
- shuma *cash* prej 164.331 lekësh të përfshihet në analizën financiare të blerjes së autoveturës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me shumën 730.000 lekë

114. Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ka shpjeguar se: *“Shuma prej 730.000 lekësh që unë dhe bashkëshortja e kemi disponuar në bankë në muajin dhjetor të vitit 2012, në ekuivalentin prej 5.000 euro është përdorur për blerjen e autoveturës me targa ***. Përdorimi i saj është bërë në rrethanat dhe për arsyet që do të shpjegoj më poshtë:*

*Në datën 10.12.2012, pasi rashë dakord edhe për çmimin, unë kam nënshkruar më shoqërinë ‘***, kontratën për blerjen e një autoveture tip ‘Ford, modeli C Max’, kundrejt shumës prej 14.900 euro. Atë ditë unë kam lidhur vetëm kontratën dhe sipas saj, pagesa e çmimit të të bëhej përpara dorëzimit të automjetit.*

*Në paraditen e datës 11.12.2012, unë jam telefonuar nga zyrat e shoqërisë ‘***’ dhe më është kërkuar që të paraqitesha për të bërë pagesën. Gjendja cash që kisha në banesë, përfshi edhe huan prej 5000 euro që më kishte dhënë shtetasi Z. D. (më sipër janë përshkruar edhe rrethanat), nuk e plotësonte shumën prej 14.900 euro dhe ato momente e kisha absolutisht të pamundur që si unë ashtu edhe bashkëshortja të tërhiqim para (saktësisht shumën prej 730.000 lekë) nga llogaritë bankare të pagës.*

Menjëherë jam lidhur në telefon me shokun tim E. V. duke i treguar për nevojën që kisha dhe ai më ka konfirmuar se e dispononte atë moment shumën prej 5.000 eurosh dhe pa vonesë ma ka vënë në dispozicion me qëllim që të kryeja pagesën e makinës. Me sa kujtoj ai më ka shpjeguar se kishte gjendje “cash” në euro, mbasi po përgatitej për të bërë një udhëtim jashtë shtetit në muajin janar”.

Mendimi i vëzhguesit ndërkombëtar në lidhje me shumën 730.000 lekë

115. Përveç huas prej 5.000 euro nga z. Z. D., subjekti i vlerësimit ka marrë një hua afatshkurtër nga miku i tij, z. E. V., e cila konfirmohet nga deklaratat noteriale të lëshuar prej tij. Subjekti i vlerësimit nuk e ka deklaruar këtë hua afatshkurtër në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012.

Në shpjegimet e tij dhënë Komisionit, fillimisht deklaroi se kjo pjesë e vlerës së makinës u pagua nga kursimet, çka ka ndodhur, pasi kursimet e subjektit kanë shërbyer si burimi i vetëm për këtë pjesë së vlerës së mjetit.

116. Në rastin në fjalë, aspekte të caktuara të transaksioneve të verifikuara kanë lidhje logjike, nga të dhënat bankare dihet se subjekti ka tërhequr shumën prej 580.000 lekësh në fund të dhjetorit. Subjekti Genc Qana shpjegon se kjo tërheqje e konsiderueshme është bërë për të shlyer mikun e tij dhe deklaroi saktë se kjo pjesë e vlerës së automjetit është paguar nga kursimet.

117. Është e vërtetë se subjekti Genc Qana fillimisht nuk e ka shpjeguar qartë huan e marrë nga z. E. V., por nuk ka fshehur të vërtetën, pasi kursimet e tij në fakt kanë shërbyer si burim i vetëm për këtë pjesë së vlerës së mjetit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

118. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratën në seancë dëgjimore, (v) dhe mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar arsyeton në lidhje me shumën 730.000 lekë se:

119. Huaja në shumën 5.000 euro marrë shtetasit E. V. u deklarua për herë të parë nga subjekti në pyetësin nr. 4²⁸, kur u pyet nga Komisioni, lidhur me destinacionin e tërheqjeve të shumave. Kjo hua nuk u deklarua nga subjekti as në DPV-në e vitit 2012 dhe as në deklaratën *Vetting*, si burim për blerjen e kësaj autoveture.

120. Pretendimi i subjektit, për përfshirjen e saj në analizën financiare të burimeve të deklaruara të krijimit të kësaj pasurie, vlerësohet një pretendim i papranueshëm, për sa kohë ky proces rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë buron nga dispozitat kushtetuese dhe parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar me saktësi, vërtetësi jo vetëm pasuritë në pronësi, por edhe “burimit” në momentin e krijimit të tyre

121. Nga analizimi i deklaratës së interesave privatë të vitit 2012 dhe i deklaratës së pasurisë *Vetting*, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar që pagesa për blerjen e automjetit ishte financuar edhe nga huaja e marrë nga shtetasi E. V..

122. Ky fakt nuk ishte materializuar në një dokument ligjor në kohën e dhënies së shumës së pretenduar, nuk ishte provuar me dokument justifikues ligjor dhe nuk ishte deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012 (e cila shërben si provë në këtë proces në bazë të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016) dhe as në deklaratën e pasurisë *Vetting*, si dhe nuk ishte deklaruar as në pyetësin standard të dërguar nga Komisioni.

123. Pretendimi i subjektit, se *deklarimi i kësaj marrëdhënieje nuk është bërë as në deklaratën “Veting”, pasi aty deklarohet vetëm burimi përfundimtar për blerjen e një pasurie*, është i gabuar dhe, për më tepër, nuk përkon në kohë.

124. Subjekti i rivlerësimit ka qenë person që mbart detyrimin për të deklaruar që prej vitit 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe duhet ta dinte që burimi i krijimit konsiston në të ardhurat financiare të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve.

125. Ditën që u pagua çmimi për blerjen e autoveturës tip “Ford Focus”, në shumën 14.900 euro (datë 11.12.2012), me mandatpagesë në “Credins Bank”, në favor të shoqërisë “***”, me përshkrim “arkëtim blerje makine”²⁹, sipas të dhënave bankare subjekti dhe bashkëshortja kanë

²⁸Përgjigje e pyetjes nr. 4, dërguar në datën 25.1.2021.

²⁹Paraqitur në pyetësin II, nga subjekti.

pasur likuiditete në vlerën 2.148.264 lekë. Pra, në krahasim me datën 1.1.2012, këto vlera monetare gjendje në llogaritë bankare janë shtuar me shumën 672.699 lek.

126. Trupi gjykues vlerëson se fakti që subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur gjendje vlera monetare në bankë në datën 11.12.2012 të disponueshme për të paguar çmimin e blerjes së autoveturës në llogari rrjedhëse, lehtësisht të transferueshme dhe ky fakt e bën të pakuptimtë shpjegimin e subjektit se u detyrua të marrë hua nga miku i tij, ditën e pagesës së automjetit.

127. Në vijim të këtij arsytimi, gjendet i pabesueshëm nga trupi gjykues edhe shpjegimi që subjekti i rivlerësimit ka bërë për sa i përket arsyes se dhe nxitimit të tij për të marrë këtë hua nga miku i tij, pavarësisht se kishte nënshkruar me shitësin kontratën e shitblerjes së këtij automjeti, që nënkuptonte se kishte detyrimin për të paguar gjithë vlerën e automjetit.

128. Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe qëndrimi i tij gjatë hetimit administrativ në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë, në lidhje me këtë burim krijimi, i krijuan bindjen trupit gjykues se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë burim krijimi ishin përpjekje të subjektit për të justifikuar diferencën negative të rezultuar për vitin 2012.

129. Përfundimisht, duke vlerësuar të gjitha provat, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga huaja e pretenduar e marrë nga shtetasi E. V. nuk mund të përfshihen në analizën e treguesve financiarë dhe nuk duhet të merret në analizë si burim krijimi për këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklaratimit të pasaktë, për sa kohë nga analiza e rrethanave faktike si më sipër është e pamundur të arrihet në një konkluzion të qartë dhe bindës se cilat janë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me krijimin e kësaj pasurie.

129.1 Për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, Komisioni, referuar dhe vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vlerëson se e ka të pamundur të dallojnë se cili deklaratim është i vërtetë dhe cili ka qenë shkak i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin.

129.2 Trupi gjykues çmon të nënvizojë se përveç mungesës së koherencës në deklarime, konstaton përpjekjen e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes të të dhënave, të cilat do shpëtonin atë nga situata që lidhej me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie të tij, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit lidhur me shpenzimet e udhëtimit në Korfuz, në shumën 1.299 euro

130. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Në analizën e treguesve financiarë, periudhën 1.1.2012 – 11.12.2012, te rubrika ‘Shpenzime, bileta, udhëtime’, nuk duhet të përfshihet si shpenzim shuma prej 181.327 lekë (ekuivalenti i 1.299 euro), pasi provohet se shpenzimet e qëndrimit për udhëtimin në Korfuz në datat 22-29 Qershor 2012, janë paguar nga shoku im i quajtur E. V.. Lidhur me këtë rast shpjegoj si vijon:*

*Me shtetasin E. V. kam jo vetëm shoqëri por edhe miqësi familjare dhe ka qenë këmbëngulja e tij që të organizonte dhe paguante një udhëtim një javor në Korfuz, me rastin e ditëlindjes së vajzave të mia A. dhe A. Q., pasi mbushnin 5 vjeç. Nga gjithë provat që do t’ju paraqes, provohet plotësisht se udhëtimi është bërë nëpërmjet shoqërisë ‘***’, komunikimin me të cilën e ka patur shoku im i quajtur E. V. dhe nga komunikimet e tij më shoqërinë duket qartë se ai është edhe personi që ka kryer pagesës.*

Financimin e këtij shpenzimi të tij unë e kam deklaruar për herë të parë në procesverbalin e datës 11.02.2016 të mbajtur pranë ILDKPKI-së, mbasi jam pyetur dhe kam dhënë shpjegime për udhëtimet jashtë shtetit dhe më pas edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, të dërguar gjatë procesit të rivlerësimit.

Në vitin 2012, nuk ishte objekt deklarimi shpenzimet e kryera, pra kishte një vakum ligjor.

Për këtë arsye nuk është deklaruar prej meje shpenzimi i kryer nga shtetasi E. V. për udhëtimin në Korfuz, si dhe në të njëjtën kohë financimi për përbashkimin e shpenzimit. Në praktikën tashmë të konsoliduar të Komisionit është njohur përbashkimi i shpenzimeve nga të tretë edhe nëse ato janë deklaruar në pyetësonin standard. Në rastin tim, përbashkimi i këtij shpenzimi përveç këtij pyetësoni është deklaruar edhe në procesverbalin e datës 11.02.2016, të cilin Komisioni në praktikën e tij e ka konsideruar në cilësinë e provës”.

Mendimi i Vëzhguesit ndërkombëtar në lidhje me udhëtimin në Korfuz.

131. Subjekti Genc Qana shpjegon se z. E. V. është mik i ngushtë i familjes dhe se ka paguar edhe një udhëtim familjar të përbashkët një javor, në Korfuz, Greqi³⁰. Udhëtimi kushtoi afërsisht në shumën 181.327 lekë, konvertuar në euro në shumën 1.299. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar udhëtimin e qershorit të vitit 2012 dhe ka informuar Komisionin në pyetësonin standard se shpenzimet e udhëtimit i ka mbuluar z. E. V.. Subjekti i ka deklaruar këto shpenzime edhe në pyetësonin e hartuar në datën 11.2.2016, nga ILDKPKI. Pra, nuk ka *indicie* që tregojnë se subjekti ka pasur për qëllim të fshehtë këtë dhuratë. Gjithashtu, subjekti i ka paraqitur Komisionit dokumente që vërtetojnë se z. E. V. ka pasur mundësi dhe të ardhura të ligjshme për dhurimin.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

132. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratet në seancë dëgjimore, (v) dhe mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar arsyeton për shpenzimet e udhëtimit në Korfuz në shumën 1299 euro se:

- Marrja në konsideratë e deklaratës noteriale të datës 24.2.2021, nga shtetasi E. V., i cili deklaron se: *“Në muajin qershor të vitit 2012, unë deklaruesi i kam organizuar familjes së shokut tim të quajtur Genci Qana një udhëtim një javor në Korfuz Greqi familjarisht, i cili ka kushtuar 1290 euro”*, duhet trajtuar në kuadër të dokumentit shkresor, në kuptim të germës “c”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

- Vlera provuese e kësaj deklarate duhet të vlerësohet, rast pas rasti, duke mbajtur në konsideratë pajtueshmërinë e përmbajtjes së saj me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar gjatë hetimit administrativ në referim të sa vijon

- Fakti që subjektit ky shpenzim udhëtimi i ishte paguar nga miku i tij, shtetasi E. V., i cili ushtronte së bashku me bashkëshorten profesionin e avokatit, duhej të ishte deklaruar pranë organit kompetent të ILDKPKI-së, si një trajtim preferencial, në vitin e dhurimit /ofrimit të këtij udhëtimi, në deklaratën periodike vjetore përkatëse për t’iu mundësuar organeve kompetente edhe kontrollin mbi konfliktin e interesave.

- Nga verifikimi në sistemin *TIMS*, vërehet se ky udhëtim u krye vetëm nga familja e subjektit dhe jo edhe nga shtetasi E. V., i cili pretendon se e pagoi këtë udhëtim, por familjarët e tij nuk morën pjesë në udhëtim, çon trupin gjykues në konkluzionin se nuk kemi të bëjmë me një udhëtim të përbashkët, por me një dhuratë dhe trajtim preferencial, i cili nuk rezulton të jetë deklaruar në deklarinin vjetor të vitit 2012.

- Provat shkresore të sjella nga subjekti provojnë vetëm se komunikimi për kryerjen e kësaj pagese është kryer nga ky shtetas por nuk provojnë pronësinë e likuiditeteve për kryerjen e kësaj pagese.

133. Në vlerësim të legjislacionit në fuqi, trupi gjykues vlerëson se ishin situata të tilla për të cilat duhet të tregohet vëmendje e shtuar, në këndvështrimin edhe të lidhjes së këtyre trajtimeve dhe

³⁰ Deklaruar edhe në pyetësonin e ILDKPKI-së në datën 11.2.2016.

dhuratave me konfliktin e interesit te zyrtarit raportues arsyeja pse legjislatori ndryshoi parashikimet në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” me ligjin nr. 85/2012³¹ me të cilin pas germës “ë”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, shtohet germa “f”, me këtë përmbajtje: f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale

134. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe vlerësoi provat e paraqitura, arriti në përfundimin se deklarimi i subjektit për mbulimin e udhëtimit në muajin qershor të vitit 2012 nga shtetasi E. V., nuk mund të pranohet, pasi nuk mbështetet në prova dhe ligj dhe, për rrjedhojë, nuk duhet zbritur kjo kosto udhëtimi nga analiza financiare në vitin 2012.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi huan në shumën 5.000 euro nga z. Z. D.

135. Subjekti, në parashtesën e tij, ndër të tjera, ka sqaruar se: “Sikurse e kam shpjeguar edhe më parë, me shtetasin Z. D. jam shok që nga fëmijëria dhe me lidhje familjare të ngushta si për sa i takon familjeve të origjinës, ashtu edhe të familjeve aktuale. Shuma hua prej 5.000 euro, më është ofruar vullnetarisht prej tij në datën 10.12.2012, kur unë kam lidhur kontratën për blerjen e autoveturës së markës ‘Ford’, me targa *** (data 10.12.2012), moment ku ka qenë i pranishëm së bashku me mua. PAGESA E SHUMËS SË BLERJES SË AUTOMJETIT DO TË BËHEJ NË VIJIM MBAS LIDHJES SË KONTRATËS DHE PËR KRYERJEN E SAJ ISHTE OPSIONI I PAGESËS CASH DHE AI ME KREDI, MBASI PAGUHEJ NJË SHUMË NË VLERËN QË ME SA KUJTOJ DUHEJ TË ISHTE 35% E VLERËS. MËNYRA E DYTË NDONËSE ISHTE MË LEHTËSISHT E REALIZUESHME, KISHTE NJË KOSTO SHITESË NË FUNDIN E SAJ (PRA PAS SHLYERJES SË KREDISË) PREJ RRETH 2 MIJË EURO, KOSTO E CILA SHTOHEJ EDHE NGA FAKTI QË GJATË PESË VITEVE TË KREDISË DUHEJ QË AUTOMJETI TË SIGUROHEJ NË OPSIONIN “full casco”. Ndërsa mënyra e dytë e pagimit “cash” ishte më me leverdi ekonomike, por paraqiste vështirësi për mua mbasi nga një përlllogaritje e gjendjes së likuiditeteve që disponoja (cash edhe në bankë) më mungonte një shumë prej rreth 5.000 eurosh.

Normalisht, në kushtet kur shoku im më vetofroi që të më jepte për të më ndihmuar një shumë prej 5000 euro (pa interes) unë padyshim që zgjodha përfundimisht opsionin që pagesën për blerjen e automjetit të bëja cash. Shuma hua më është dhënë nga shoku im, shtetasi Z. D., që në datën 10.12.2012, pasi disponohej prej tij dhe është marrë nga ana ime pa ndonjë dokument konfirmues. Nuk ka asnjë dyshim që shtetasi Z. D. ka patur atë kohë mundësinë për të më siguruar një shumë prej 5.000 euro cash. Bashkëlidhur me pyetësonin nr. 2, ju kam përcjellë dokumentacionin që vërteton pronat e tij të paluajtshme dhe të luajtshme, përfshi edhe llogaritë bankare apo bono thesari. Nisur nga vlera e këtyre pasurive dhe vendndodhja e tyre, duket qartë se shuma prej 5.000 euro që më është siguruar prej tij është një shumë fare modeste për mundësitë që ka patur. Vetëm fakti që në fillimi të vitit 2012 ai ka blerë për vete një autoveturë në shumën prej 13.200 euro, tregon qartë se i ka patur mundësitë financiare për të kryer një veprim të tillë dhe kjo është e mjaftueshme për të krijuar edhe bindjen se sigurimi i një shume prej 5.000 euro cash nuk ka qenë ndonjë problem për të.

Është e vërtetë se nuk ka ndonjë dokument që të provojë se shtetasi I. S. D. ka autorizuar në mënyrë të veçantë vëllain e tij, shtetasin Z. D., të përdorë të ardhurat e tij. Por, është fakt i dokumentuar se shtetasi I. D. për administrimin e pronave të tij dhe të ardhurave që realizohen prej tyre, me prokurën e posaçme me nr.***, datë 1.9.2005, ka autorizuar për një kohë të pacaktuar nënën e tij (dhe të Z.), shtetasen L. D..

Për sa i takon të ardhurave që shtetasi Z. D. ka realizuar nga dhënia me qira e një ambienti me sipërfaqe prej 77 m², në bashkëpronësi me xhaxhain e tij S. D., unë kam administruar dhe kërkoj që të merren si prova kontratat e qirasë me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. dhe mandatet origjinale të viteve 2000 – 2012, që konfirmon pagesën e tatimit për qiranë. Lidhur me pagimin e tatimit të qirasë, në vlerën prej 140.000 lekësh për vitet 2009 dhe 2010, që konfirmohet nga ana e DRTT-së, dua të sqaroj se ndonëse në organet tatimore mund të figurojë si tatimpagues vetëm emri i

³¹Miraturar në datën 18.9.2012, Dekret Presidenti, datë 9.10.2012.

shtetasit S. D., tatimi është paguar për të gjithë vlerën e qirasë së marrë, pasi kemi të bëjmë me të njëjtin objekt dhe të njëjtën kontratë si për të ashtu edhe për shtetasin Z. D.. Për më tepër që, nëse shihen me kujdes mandatet që po paraqes si provë, në shumicën e tyre emri i personin që ka realizuar pagesën është pikërisht ai i shtetasit Z. D.”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

136. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, në lidhje me huan në shumën prej 5.000 euro, marrë shtetasit Z. D., arsyeton se:

137. Nga analizimi i mandat-pagesave së tatimit mbi të ardhurat nga qiraja (të dërguar nga subjekti me prapësimet e rezultateve të hetimit), trupi gjykues arsyeton se shuma totale e tatimit të paguar sipas këtyre mandateve është në vlerën 744.656 lekë. Të ardhurat *neto* të përfituara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore (nga mandatet e dorëzuara sa më sipër) do të rezultojnë në vlerën 6.701.904 lekë (7.446.560 lekë -744.656 lekë dhe pjesa takuese e shtetasit Z. D. do të rezultonte në vlerën 3.350.952 lekë (50% e të ardhurave), ndonëse në pjesën më të madhe të mandateve urdhërues i veprimit rezulton ortak S. D..

138. Nëse do të llogariteshin shpenzimet minimale për konsum, vetëm për shtetasin Z. D., këto shpenzime janë në shumën 1.589.607 lekë (për periudhën 2000 – dhjetor 2012). Gjithashtu, vlen për t’u evidentuar se disa muaj përpara dhënies së huas subjektit të rivlerësimit, huadhënësi ka investuar në blerjen e një autoveture të re në shumën 13.200 euro (konvertuar në afro 1.800.000 lekë).

139. Komisioni, për të evidentuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të deklaruara, mundësinë financiare të huadhënësit për huan e dhënë në shumën 5.000 euro në dhjetor të vitit 2012, kreu një analizë financiare (të ardhura/shpenzime)³² për periudhën e sipërcituar, nga e cila, duket se shtetasi Z. D. nuk ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme për dhënien e huas subjektit në dhjetor të vitit 2012, referuar tabelës si vijon:

Analizë të ardhura/shpenzime	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga qiradhënia për periudhën 2000 – dhjetor 2012 (pjesa takuese dokumentuar)	3.350.952
Total të ardhura /të hyra financiare	3.350.952
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	1.589.607
Blerje autoveturë në janar 2012 shuma 13.200 euro	1.833.876
Pagesa për blerje ap. tek “***”, me kontratë sipërmarrje, datë 14.3.2002, shuma 12.704 USD	1.699.033
Hua e pretenduar dhënë subjektit në dhjetor 2012, shuma 5.000 euro	697.950
Total shpenzime/të dala financiare	5.820.466
Balanca e fondeve	-2.469.514

140. Trupi gjykues vlerëson se mbështetur në përcaktimet e pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 19, të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua, duke mos u dokumentuar mundësia financiare e personit tjetër të lidhur për dhënien e huas.

³²Në analizë nuk janë përfshirë pasuri, investime të tjera të krijuara ,si dhe të ardhura, shpenzime të tjera të realizuara nga huadhënësi

141. Sa më sipër, të ardhurat e dhëna hua përdorur si burim për pasurinë automjet, bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nuk u provuan se janë të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

142. Trupi gjykues, referuar arsyetimit ligjor të mësipërm, arriti në përfundimin, huaja e marrë nga shtetasi Z. D. nuk mund të përfshihet në analizën financiare viti 2012.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me gjendjen *cash* prej 164.331 lekësh

143. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *“Në analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.10.2011 – 31.12.2011, është përfshirë gabimisht shuma prej 330.000 lekë që është përdorur për mobilimin e apartamentit në Orikum. Kjo shumë nuk duhet që të përfshihet në këtë analizë, pasi në asnjë moment unë nuk kam shpjeguar se ajo është krijuar nga kursimet e mia për periudhën nga 1.10.2011 – 31.12.2011. Realiteti është që unë kam pasur gjendje *cash* të ngelur mbas blerjes së apartamentit, e cila më pas është përdorur për mobilimin e tij. Nëse do të ribëhet analiza financiare për vitin 2011, sipas gjithë kërkesave të mia të mësipërme, do të vihet re se unë kam pasur gjendje të mjaftueshme *cash* në datën 1.10.2011, me qëllim për të përdorur në vijim për mobilimin e tij. Në këto rrethana, kërkoj ribërjen e analizës së treguesve financiarë, periudha 1.10.2011 – 31.12.2011, duke hequr prej saj shumën prej 330.000 lekësh të shpenzimeve për mobilimin e apartamentit në Orikum. Për rrjedhojë, pas rikryerjes së kësaj analize duhet që shuma *cash* prej 164.331 lekësh të përfshihet në analizën financiare të blerjes së autoveturës së markës Ford”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

144. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, mbi gjendjen *cash* 164.331 lekësh, arsyeton si vijon:

145. Shpenzimet për mobilim/arredim janë pasqyruar në kohë dhe vlerë, referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve ku në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *Arredimi i kësaj banese, nisur edhe nga qëllimi për të cilin përdoret, është bërë për nevoja bazike dhe me materiale jo të kushtueshme. Pas blerjes, në tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011, është shpenzuar për arredim shuma prej rreth 330,000 lekësh ...”.*

146. Pra, në analizën për periudhën 1.10.2011 – 31.12.2011, vendosja e shumës së shpenzuar për mobilim/arredim mbështetet në kohë dhe vlerë sipas deklaratimit të subjektit sa më sipër.

147. Trupi gjykues arrin në përfundimin se gjendja *cash* në shumën prej 164.331 lekësh, nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri.

Lidhur me shumën prej 4.000 USD dhënë dhuratë nga vjehri T. P.

148. Shpjegimet e subjektit, lidhur me marrëveshjen për pagimin e tatimeve midis paleve ishin bindëse. Subjekti arriti të dokumentojë mundësinë financiare e personit tjetër të lidhur/babait të bashkëshortes për dhënien e dhurimit, duke provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të dhuruara të përdorura si burim për pasurinë automjet, sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit ndaj këto të ardhura u përfshinë në analizën financiare.

Analiza e treguesve financiarë për këtë pasuri

149. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, vlerësimin e prapësimeve dhe provave të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe verifikimin e kryer për burimet financiare të deklaruara për blerjen e pasurive, shtesat në likuiditete dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2012 – 11.12.2012, si vijon

Analiza perfundimtare e treguesve financiarë periudha 1.1.2012 – 11.12.2012	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat subjekti i rivlerësimit për periudhën në “Credins Bank”	1.405.102
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërblime bashkëshortja në “Credins Bank”	149.091
Të ardhura në formë dhurimi nga babai i bashkëshortes shuma 4.000 USD	423.400
Të ardhura nga shitja e autoveturës datë 7.11.2012, në shumën 1.000 euro	139.880
Te ardhura interesa depozita e bashkëshortes në “ProCredit bank”	27.632
Total të ardhura /të hyra financiare	2.145.105
Shpenzime për “Vodafone” paguar nëpërmjet “Credins Bank” për periudhën	48.488
Shpenzime mobilim/arredim apartament, Oriku, deklaruar në pyetësin nr. 2	120.000
Shpenzime udhëtimi dhe transport në Korfuz në qershor të viti 2012	199.474
Shpenzime për rivl.e pasurisë ap.me sip.115.97 m ² në korrik 2012 (pyetësi nr. 4)	93.331
Shpenzime për regjistrim të pasurive të dhuruara nga babai i bashkëshortes në shtator 2012	18.150
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	659.507
Total shpenzime/të dala financiare	1.138.950
Ndryshim mj. monetare cash deklaruar/llogaritur gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-672.699
Mjete monetare të disponueshme (1)	333.456
Blerje autoveturë tip “Ford Focus”, në vlerë 14.900 euro, në datën 11.12.2012	2.081.828
Detyrime	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	2.081.828
Balanca e fondeve (1-2)	-1.748.372

150. Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me burimet financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e autoveturës tip “Ford Focus” në datën 11.12.2012, në shumën 14.900 euro, shtesën në likuiditete bankare dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara, për periudhën 1.1.2012 – 11.12.2012, duke rezultuar me balancë negative në vlerën 1.748.372 lekë, duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

151. Ndhimja/hua nga shtetasi E. V., si burim për blerjen e automjetit nuk rezulton e deklaruar në DPV-në e vitit 2016 dhe as në deklaratën *Vetting*, ndaj Komisioni, referuar dhe vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vlerëson se ky ndryshim burimi e bën të pamundur të identifikohet se cili deklarim është i vërtetë si dhe se cili ka qenë shkak i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin e krijimit për këtë pasuri.

151.2. Mungesa e koherencës në deklaratimet e subjektit mbi burimet e krijimit vlerësohet nga trupi gjykues si përpjekje e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes të të dhënave, të cilat do shpëtonin atë nga situata që lidhej me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie të tij, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

4. Llogari rrjedhëse pranë “Credins Bank”, në emër të subjektit, e krijuar për shkak të pagesës së pagës si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Tiranë në shumën 1.155.16 lekë

152. Komisioni vëren se nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga “Credins Bank”³³, në kuadër të hetimit administrativ të kryer, konfirmohet gjendja e kësaj llogarie në momentin e deklaratimit.

5. Likuiditete në gjendje *cash* në shumën 550.000 lekë

153. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi, kursimet familjare për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2019.

154. Referuar deklarimeve periodike vjetore të sipërpërmendura, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) në DPV/2014, *shtesë në para cash dhe në llogarinë bankare, të ndodhur pranë “Credins Bank” në shumën 300.000 lekë, me burim krijimi “kursime”*; (ii) në DPV/2015, *shtesë në para cash në shumën 185.000 lekë, me burim krijimi “kursime”*; (iii) në DPV/2016, *shtesë në para cash shumën 65.000 lekë, me burim krijimi “kursime”*.

Bazuar në analizën e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, duket se për periudhën 2014 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi krijimin e gjendjeve *cash* të deklaruara.

Pasuri të deklaruara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. Natalja Qana

6. Pasuria e luajtshme automjet tip “FIAT Punto”

155. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Autoveturë e markës ‘FIAT Punto’, prodhimi i vitit 2001, me targa *** dhe numër shasie ***, regjistruar pranë DPSHTRr-së Tiranë, me certifikatë pronësie nr. ***, datë 5.2.2013. Burimi i krijimit: me të ardhura nga kursimet familjare nga shtetasi A. V., me kontratën nr. ***, datë 2.2.2013, të noteres G. B.”*

156. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë në pasuri të luajtshme, një autoveturë e tip “FIAT Punto”, me targa *** dhe numër shasie ***. Blerë në datën 2.2.2013, nga shtetasi A. V.. Burimi i krijimit: blerë me të ardhurat nga kursimet”*.

157. DPSHTRr-ja³⁴ ka vënë në dispozicion dosjen e plotë të këtij automjeti nga verifikimi i të cilës konstatohet se: (i) me kontratën e shitblerjes, datë 2.2.2013, ky automjet është blerë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në shumën 150.000 lekë; (ii) në datën 5.2.2013 është bërë regjistrimi i automjetit tip “FIAT Punto”, me targa ***, në emër të N. Q..

158. Sipas kësaj kontrate çmimi në shumën 150.000 lekë është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

159. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara/provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si edhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për periudhën 1.1.2013 – 2.2.2013, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, për blerjen e pasurisë autoveturë tip “FIAT Punto”, të pasqyruar në tabelën si vijon

Analiza e treguesve financiarë periudha 1.1.2013 – 2.2.2013	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat subjekti i rivlerësimit për periudhën në “Credins Bank”	98.606
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat dhe shpërbleme bashkëshortja në “Credins Bank”	40.868
Te ardhura interesa	28.312
Total të ardhura /të hyra financiare	167.786
Shpenzime për “Vodafone” paguar nëpërmjet “Credins Bank” për periudhën	6.682
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	63.750
Total shpenzime/të dala financiare	70.432
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar/llogaritur gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-160.982
Mjete monetare të disponueshme (1)	-63.628
Blerje autoveturë tip “FIAT Punto”, në datën 2.2.2013	150.000
Detyrime	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	150.000
Balanca e fondeve (1-2)	-213.628

160. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit se duket se, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e auto veturës tip “FIAT Punto” në datën 2.2.2013, në shumën 150.000 lekë, shtesën e likuiditeteve në bankë,

³⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.4.2019, DPSHTRr-së.

si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2013 – 2.2.2013 (balanca negative e llogaritur në vlerë negative prej -213.628 lekësh).

161. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “Ky automjet është blerë për nevoja të lëvizjes së përditshme nga bashkëshortes në shumën 150.000 lekë. Realisht këtë shumë nuk e kam disponuar ato momente dhe ajo më është dhënë në formë ndihme për pak kohë nga prindërit e bashkëshortes, më pas (me sa kujtoj brenda muajit maj 2013) shuma prej 150.000 lekësh e dhënë në formë ndihme u është kthyer përsëri dhe në këto kushte, autovetura rezulton e blerë nga kursimet e krijuara nga familja ime (unë dhe bashkëshortja) për vitin 2013. Shuma prej 150.000 lekësh është relativisht e vogël dhe për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare nuk kemi përpiluar ndonjë dokument noterial dhe për rrjedhojë unë nuk mund të paraqes ndonjë provë për ta vërtetuar”.

162. Komisioni në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, lidhur me barrën e provës për mundësinë financiare për blerjen e automjetit tip “FIAT Punto”, vlerëson se në DPV-në e vitit 2013 dhe në deklaratën *Vetting*, nuk është deklaruar ndihma/huaja e pretenduar nga prindërit e bashkëshortes si burim për blerjen e këtij automjeti, për më tepër që për periudhën 1.1.2013 – 2.2.2013, vlerat monetare në bankë në emër të subjektit dhe bashkëshortes janë shtuar.

163. Referuar sa më sipër, për pasurinë automjet Komisioni arrin në konkluzionin përfundimtar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk ka arritur të dokumentojë burimet e të ardhurave për blerjen e autoveturës në datën 2.2.2013, në shumën -150.000 lekë.

164. Shpjegimet e dhëna nga subjekti, lidhur me barrën e provës për ndihmën/huan nga prindërit e bashkëshortes se si burim për blerjen e automjetit tip “FIAT Punto”, nuk rezulton e deklaruar në DPV-në e vitit 2013 dhe në deklaratën *Vetting*, dhe nuk provohen me dokumentacion ligjor.

164.1 Për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, Komisioni, referuar dhe vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vlerëson se e ka të pamundur të dallojë se cili deklarim është i vërtetë dhe cili ka qenë shkak i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin.

164.2. Trupi gjykues çmon të nënvizojë se përveç mungesës së koherencës në deklarime, konstatohet përpjekja e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes të të dhënave, të cilat do shpëtonin atë nga situata që lidhej me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie të tij, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

7. Pasuritë e personit të lidhur/bashkëshortes, znj. N. Q., dhuruar nga babai

166. Pasuritë e bashkëshortes së subjektit janë si vijon:

- 1) apartament banimi m sip. 115.97 m², i ndodhur në adresën: rruga “****”, nd. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë;
- 2) garazh nëntokësor me sip. 21.5 m², i ndodhur në adresën: rruga “****”, nd. ***, Tiranë;
- 3) garazh nëntokësor me sip. 18.6 m², i ndodhur në adresën: rruga “****”, Tiranë.

167. Në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, pjesë e deklaratës *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar si burim të krijimit të këtyre pasurive, dhuruar pa kusht dhe pa shpërblim, nga shtetas T. P. (babai i saj), me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 22.9.2012. Gjithashtu, znj. Natalja Qana (bashkëshortja e subjektit), shpjegon se këto pasuri janë përfituar prej tij në cilësinë e pronarit të një trualli me sip. 750 m² në rrugën “****”, Tiranë, sipas kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 26.7.2012.

168. Në DPV-në e vitit 2012, në deklaratën e pasurisë të personit të lidhur/bashkëshortja e subjektit, ndër të tjera, ka deklaruar apartamentin me sip. 115.97 m² dhe dy garazhet përkatësisht me sip. 21.5 m² dhe sip. 18.6 m², në rrugën “****”, Tiranë, me burim të krijimit, dhuruar pa kusht dhe pa shpërblim, nga shtetas T. P. (babai i saj)

169. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 8.9.2004³⁵, e lidhur midis shtetasit T. P., në cilësinë e pronarit të truallit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë ndërtuese, ka për objekt vënien në dispozicion për ndërtimin e një objekti shumëkatësh të truallit me sip. 750 m² të në pronën z. T. P. me nr. hipoteke ***, që ndodhet në z. k. *** me nr. pasurie ***, në rrugën “****” dhe në përfundim të objektit pronari i truallit do të përfitojë 30% të sipërfaqes së ndërtimit. Në datën 15.6.2006, është lidhur kontrata e sipërmarrjes shtesë³⁶ me nr. ***, midis shtetasit T. P. në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. në cilësinë e shoqërisë.

170. Komisioni, në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin që provon burimin e ligjshëm të krijimit të pronësisë së pasurisë së dhuruar, duke kërkuar dokumentacionin ligjor provues mbi truallin në emër të z.T. P..

171. Nga administrimi i dokumentacionit të pronësisë, z. T. P., ka përfituar bashkë me nënën tij (të ndjerën E. P.), nëpërmjet testamentit lëshuar nga i ati i tij (i ndjeri Z. P.), një banesë që gjendet në lagjen “****”, rruga “****”, Tiranë, e përbërë nga tri dhoma, një kuzhinë dhe anekset e tjera, transkriptuar në zyrën e hipotekave të Tiranës me nr. ***, datë 11.12.1964 dhe nr. ***, datë 3.3.1965 dhe një verandë me oborr më sip. 223 m².

172. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me pasurinë e dhuruar bashkëshortes nga babai i saj në vitin 2012, apartament me sip. 115.97 m², në rrugën “****”, Tiranë subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Ndonëse ky apartament është bërë efektiv për banim në muajin mars të vitit 2009 (pasi atëherë përfundoi dhe lidhja me rrjetin elektrik dhe të ujësjellësit), porosia për arredimin e tij ka filluar që në muajin Nëntor të vitit 2008. Në vitin 2008, për arredimin e këtij apartamenti është shpenzuar shuma prej rreth 200,000 lekë. Në vitin 2009, për arredimin e këtij apartamenti është shpenzuar shuma prej rreth 400,000 lekë. Në vitin 2010, për arredimin e këtij apartamenti është shpenzuar rreth 300,000 lekësh.”*

173. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4³⁷, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...sikurse e kam shpjeguar edhe më parë, apartamenti është bërë efektiv për banim diku rreth muajit Mars të vitit 2009, muaj në të cilin unë, bashkëshortja dhe tre vajzat kemi filluar që të banojmë në të...”*

...vlerësoj se deklarimi im periodik dhe i bashkëshortes për periudhat 2008, 2009, 2010 dhe 2011, pranë ILDKPI-së ka qenë në përputhje me parashikimet ligjore të asaj kohe. Deri në muajin Korrik 2012 ne kemi banuar në një apartament i cili nuk ishte regjistruar akoma dhe për më tepër që, asnjë subjekt nuk ishte pronar ‘de jure’ i tij”.

174. Sa më sipër, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore (përfshirë edhe deklaratën e interesave private të personit të lidhur/bashkëshortes), për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, pranë ILDKPKI-së, në përputhje me përcaktimet ligjore, të drejtat mbi këtë pasuri të paluajtshme.

175. Në përfundim, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta, lidhur me përdorimin e këtij apartamenti për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, duke u ndodhur në kushtet e parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

8. Llogari kursimi pranë “ProCredit Bank”, Tiranë, në shumën 10.615,14 euro

176. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit (personi i lidhur/bashkëshortja) ka deklaruar si burim krijimi të kësaj depozite: *“Kursime nga paga te ‘Medica Tirana’ dhe interesa vjetore, që në momentin e krijimit të llogarisë”.*

177. Referuar deklarimeve periodike vjetore subjekti i rivlerësimit ka deklaruar krijimin dhe ecurinë e kësaj depozite, konkretisht: (i) në DPV-të për vitet 2009 dhe 2010 ka deklaruar shtesë

³⁵ Kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 8.9.2004, e gjendur në dosjen e ILDKPKI (fq ***)

³⁶ Shihni në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

³⁷ Përgjigje e pyetjes nr.1, dërguar në datën 25.1.2021

në këtë llogari bankare shumë përkatësisht 4.000 euro dhe 6.000 euro me burim krijimi kursimet; (ii) në DPV-të për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2016 është deklaruar vetëm interesi bankar i përfituar i cili ka qenë shtesë në llogari; (iii) ndërsa në DPV-të për vitet 2011 dhe 2015 nuk janë deklaruar shtesa/pakësime, gjendje në këtë llogari.

178. Komisioni vëren se nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga “ProCredit Bank”³⁸, në kuadër të hetimit administrativ të kryer, konfirmohet gjendja e kësaj llogarie në momentin e deklarimit në datën 26.1.2017.

179. Analiza e burimit të deklaruar të të ardhurave për krijimin/rritjen e kësaj depozite dhe mundësia financiare, është pasqyruar në analizën e plotë të treguesve financiarë.

9. Analiza e treguesve financiarë

180. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruar/provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për subjektin e rivlerësimit.

181. Trupi gjykues, pasi ka analizuar me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje, dhe shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare ³⁹

-në krijimin e pasurisë apartament me sip. 80.2 m², në Tiranë në datë 16.02.2001, në vlerën - 1.169.377 lekë;

-në krijimin e pasurisë automjet “Ford Focus” në datë 11.12.2012, në vlerën -1.748.372 lekë;

-në krijimin e pasurisë “Fiat Punto” në datë 02.02.2013, në vlerën -213.628 lekë;

-në vitin e mbyllur financiar 2011 në vlerën -343.794 lekë;

182. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka mungesë të burimeve financiare në vlerën totale prej 3.475.171 lekësh.

KONKLUZION PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË

183. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se mungesa e burimeve të ligjshme financiare në krijimin e pasurive në vlerën totale prej 3.475.171 lekësh, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61, dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b”, ligji nr. 84/2016.

184. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se shtimi/ndryshimi i burimeve të krijimit gjatë hetimit administrativ, për pasuritë vlerësohet si përppjekje e subjektit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes të të dhënave, lidhur me justifikimin e burimeve të ligjshme të këtyre pasurive të tij.

184.1 Mungesa e koherencës në deklaramet e subjektit mbi burimet e krijimit, me mungesën e burimeve të ligjshme në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, con trupin gjykues në përfundimin se vlerësimi tërësor i pasurisë së tij ka problematika nga ato që parashikon neni D i Aneksit të Kushtetutës, pika 3, e nenit 61, dhe neni 33, pika 5, germa “a”e ligjit nr. 84/2016.

184.2 Lidhur me pasurinë e përfituar nga personi i lidhur nëpërmjet dhurimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka shmangur deklaramet mbi të drejtat reale mbi këto pasuri dhe gjatë hetimit administrativ ka bërë deklarime kontradiktore, lidhur me vitet e përdorimit dhe investimit në to, duke e bërë deklaramin, lidhur me pasurinë e dhuruar të personit të lidhur, të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “a” dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se bazuar në konkluzionet e arritura më lart në konsideratë dhe të standarteve të vendosura nga Kolegji i Posacëm i Apelit, subjekti i rivlerësimit z. Genci Qana, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

³⁸ Shkresë nr. Prot ***, datë 3.5.2019.

³⁹ Në Analiza janë pasqyruar edhe shpenzimet e deklaruara dhe të evidentuara për periudhat përkatëse (analizuar me lart)

B.VLERËSIMI I FIGURËS

186. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (“DSIK”), si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve, sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin figurës, ka paraqitur pranë Komisionit raportin me nr. *** prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 7.7.2020, të KDZh-së, ku rezulton se: *Formulari i deklarimit është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Pas diskutimeve të Grupit të Punës u vendos dërgimi i kërkesës për verifikim të kontrollit të figurës në Prokurorinë e Përgjithshme, SHISH dhe SHÇBA.*

187. Nga informacioni i ardhur nga institucionet verifikuese (Prokurori e Përgjithshme, SHISH dhe SHÇBA) rezulton se: *Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.*

188. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

189. Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, konstatoi se me shkresën e dërguar nga gjendja civile konfirmohet se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë ndryshuar mbiemrin nga Qama ne Qana, duke rezultuar se është përdorur një mbiemër tjetër nga ana e subjektit të rivlerësimit, fakt ky i padeklaruar në formularin për kontrollin e figurës, sipas detyrimit ligjor për deklaram.

Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, konstatoi se me shkresën e dërguar nga gjendja civile konfirmohet se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë ndryshuar mbiemrin nga Qama në Qana, duke rezultuar se është përdorur një mbiemër tjetër nga ana e subjektit të rivlerësimit, fakt ky i padeklaruar në formularin për kontrollin e figurës sipas detyrimit ligjor për deklaram.

190. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të neneve Ç dhe DH, të Aneksit të Kushtetutës, iu kalua barra e provës subjektit për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, për sa subjekti ka plotësuar në mënyrë të pasaktë dhe jo me vërtetësi deklaratën për kontrollin e figurës, pasi nuk ka deklaruar faktin se ka pasur gjeneralitete të tjera; subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës.

191. Në përgjigje të barrës së provës së dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me përgjegjësi të plotë ligjore se që nga lindja dhe deri më sot ka mbajtur vetëm mbiemrin “Qana” dhe asnjëherë nuk e ka ndryshuar apo ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e tij.

192. Subjekti deklaroi se me këtë konstatim është njohur për herë të parë në raportin për rezultatet e hetimit që i është dërguar më 18.2.2021 dhe në datën 19.2.2021, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion pranë Zyrës së Gjendjes Civile Nr. ***, Tiranë dhe Zyrës së Gjendjes Civile Nr. ***, Berat.

193. Nga fotokopjet e fletëve përkatëse të regjistrit (të njësuara me origjinalin) të administruara vihet re se familja e origjinës ka qenë e regjistruar në gjendjen civile të qytetit të Beratit në regjistrin themeltar “****” dhe mbiemri i gjithë pjesëtarëve të familjes është “Qana”.

194. Pasi prindërit kanë blerën apartamentin 1+1, në Tiranës (datë 20.5.1996), në datën 13.6.1996, gjendja civile e gjithë pjesëtarëve të familjes së origjinës është transferuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr. ***, Berat në Zyrën e Gjendjes Civile Nr. ***, Tiranë.

195. Në momentin kur punonjësja e gjendjes civile të kësaj zyre ka plotësuar me shkrim dore fletën përkatëse (regjistri themeltar nr. ***, fleta 37) ka shkruajua gabimisht mbiemrin “Qama” për të gjithë pjesëtarët e familjes, veprim i cili mund të jetë bërë nga pakujdesia apo nga paaftësia e saj për të dalluar diferencën që ekziston midis numrit të harqeve në shkronjat “n” dhe “m”.

196. Ky “gabim material” i bërë prej saj, është korrigjuar me aktin nr. ***, datë 25.2.1997, “Për korrigjim mbiemri”, të përgjegjësës së zyrës së gjendjes civile dhe pas këtij akti në fletën e regjistrit është shënuar mbiemri i saktë “Qana” për të gjithë pjesëtarët e familjes.

197. Pra, mbiemri i gabuar ka ngelur i regjistruar vetëm për një periudhë prej rreth 8 muaj dhe, menjëherë, pasi është vënë re, mbiemri është korrigjuar duke shënuar mbiemrin e saktë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

198. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, ku në pjesën 1 “të dhëna identifikuese” pyetjes a keni pasur emër tjetër më parë, subjekti i është përgjigjur me “jo”.

199. Kjo pyetje shoqërohet me kërkesën për të dhënë detaje në lidhje me rastin kur subjekti ka përdorur emër tjetër.

200. Trupi gjykues çmon se pyetja e pjesës nr. 1, të “shtojcës 3”, “Të dhëna identifikuese”, të ligjit nr. 84/2016, nuk përcakton raste përjashtimore nga detyrimi për deklaramin e të dhënave të tjera të përdorura që të lidhen me kohëzgjatjen apo me arsyet se përse është përdorur një emër tjetër nga ana e subjekteve të rivlerësimit.

201. Në vlerësim të trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjitha mundësitë që shpjegimet e dhëna pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrative t’i jepte gjatë plotësimit të pjesës nr. 1, të “shtojcës 3”, “Të dhëna identifikuese”, të ligjit nr. 84/2016, fakt që do ta bënte deklaramin e tij të saktë dhe në përputhje me ligjin.

202. Shpjegimi i subjektit se është njohur për herë të parë me këtë fakt pas rezultateve të hetimit në vlerësim të trupit gjykues nuk është bindës për sa korrigjimi i të dhënave të gjendjes civile bëhet me kërkesën e palës së interesuar dhe se subjekti ka pasur mundësitë reale të vënies në dijeni të këtij fakti në momentin e bërjes së korrigjimit në gjendjen civile përkatëse.

203. Argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit mbi padijeninë e tij, nuk mund të pranohet pasi sfidon logjikën dhe justifikimi i parashtruar prej subjektit mbi padijeninë e tij është i papërfillshëm si arsyetim që çliron nga përgjegjësia për deklaramin subjektin.

204. Trupi gjykues çmon se mosdeklarami i kësaj rrethane, si detyrim kushtetues i subjektit të rivlerësimit, i cili ishte i përfshirë në një proces të rëndësishëm, siç është procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë si kërkesë e shprehur mjaft qartë, e vendos subjektin në kushtet e nenit “DH”, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, ku përcaktohej sanksioni kur subjekti ishte përpjekur të bënte deklaramin të pasakta.

205. Mbështetur nga dokumentacioni i administruar, te formulari i deklaramit të kontrollit të figurës nuk janë paraqitur faktet siç janë në realitet dhe koherencë deri në dorëzimin e formularit nga ana e subjektit pranë DSIK-së. Për saktësinë e deklaramit, dhe paraqitjen e vërtetë të fakteve sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk kishte asnjë pengesë të informohej e merrte dijeni si dhe ta plotësonte, me saktësi dhe vërtetësi faktet e ndodhura para plotësimit të tij.

206. Ndërkohë me nënshkrimin e deklaramit të kontrollit të figurës, subjekti ka qenë i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaramit për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËR RIVLERËSIMIN E FIGURËS

207. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të

pjesës nr. 1, të “shtojcës 3”, “Të dhëna identifikuese”, të ligjit nr. 84/2016, dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e fakteve të konstatuara lidhur me këtë.

Lidhur me kriterin për kontrollin e figurës, duke iu referuar kërkesave të nenit Dh, pikat 2 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për kriterin e kontrollit të figurës.

C.VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

208. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën së Shqipërisë”, kreu VI, nenet 40 dhe vijues i tij, si dhe mbi bazën e kriterëve përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikës së Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ku në përfundim ky organ ka dërguar raportin bazuar në Formularin e Vetëdeklarimit, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së.

ANALIZA E GJETJEVE

209. Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Genci Qana, për sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

210. Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurori dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Genci Qana shfaq aftësi në arsyetim ligjor, tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se prej tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

211. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

212. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Genci Qana, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

213. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe disponimin e gjykatës.

214. Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e shortuara, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

215. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Genci Qana dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

216. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Genci Qana. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

216. Nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e rena në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

KONKLUZION PËR RIVLERËSIMIN E AFTËSISË PROFESIONALE

217. Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, në argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, ka arritur nivel kualifikues.

D. DENONCIMET

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë protokolluar 9 denoncime për subjektin e rivlerësimit.

218. Denoncim i shtetasit A. H. regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 16.1.2018, ndaj 3 (tri) subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit.

218.1. Lidhur me kallëzimin e paraqitur, nga administrimi i dokumentacionit pjesë e fashikullit hetimor, kanë rezultuar këto fakte: kallëzuesit kanë qenë bashkëpronarë të një pasurie (trull + ndërtesë) të ndodhur në z. k. ***, me nr. pas. ***, vol. ***, f. ***, rruga “****”, Tiranë. Këtë pasuri ata e kanë vendosur kolateral për një kredi që shtetasi Dh. C., si përfaqësues i shoqërive “****” dhe “****” kishte marrë pranë “Raiffeisen Bank”, me kontratën e kredisë nr. ***, datë 24.1.2011. Subjekti i rivlerësimit ka administruar në cilësinë e provës të gjithë dokumentacionin: aktet e përmbaruesit gjyqësor, në lidhje me ekzekutimin e detyrimit; procedurën e ankandit të zhvilluar; aktin e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme; aktet e njoftimit ndaj palëve lidhur me veprimet e përmbaruesve, ka thirrur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale shtetasin A. K., në cilësinë e përmbaruesit, i cili ka ndjekur procedurën e ekzekutimit të detyrimit (datë 9.12.2014), si dhe të shtetasit D. F., në cilësinë e ekspertit, i cili ka vlerësuar pasurinë e paluajtshme (datë 10.11.2014), i ka kërkuar informacion ZVRPP-së Tiranë, lidhur me çmimet minimale fiskale të aplikuara në zonën ku ndodhet pasuria, për periudhën maj-qershor (periudha e marrë për bazë nga eksperti që ka vlerësuar pasurinë e denoncuesve).

218.2. Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 30.7.2015, ka pushuar procedimin penal për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, duke arsyetuar se për kryerjen e kësaj vepra penale kërkohen veprimet e marrjes, hedhjes në dorë në mënyrë të kundërligjshme të pasurive me qëllim përfitimin material nga persona që kanë për detyrë ta ruajnë dhe administrojnë. Në rastin konkret, rezultoi se as përmbaruesi gjyqësor dhe as eksperti nuk kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin që të kenë pasur qëllim të vjedhin pasurinë e kallëzuesve. Procedura e ankandit është zhvilluar në përputhje me dispozitat e Kodit Procedurës Civile.

218.3. Edhe për vlerësuesin rezultoi se ka kryer vlerësimin në përputhje me një procedurë ligjore dhe në përcaktimin e vlerës së pasurisë që është nxjerrë në ankand është bazuar mbi një metodologji të caktuar. Gjithashtu, edhe nga administrimi i shkresës së ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, lidhur me çmimet referuese në atë zonë, rezultoi se nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm në çmim, ndërkohë që eksperti ka paraqitur edhe argumentet në lidhje me vlerën e ulët të çmimit të aplikuar në vlerësimin e pasurisë. Për sa më lart, iu kërkuan shpjegime subjektit lidhur me konstatimet e Komisionit në lidhje me këtë denoncim.

218.4. Lidhur me denoncimin e shtetasit A. H., subjekti ka shpjeguar dhe se fillimish ka theksuar se hedh poshtë me vendosmëri çdo “aludim” se vendimi i prokurorisë është marrë si pasojë e ndërhyrjeve apo korrupsionit. Përkundër sa pretendon denoncuesi subjekti siguron se në vendimmarrjen për pushimin e procedimit penal nr. ***, nuk ka pasur asnjë ndikim të jashtëm, qoftë në formë ndërhyrje apo korrupsioni. Vendimi është marrë bazuar vetëm në vlerësimin

objektiv të gjithë provave të administruar gjatë hetimit, të cilat në mënyrë të hollësishme janë përshkruar në pjesën konstatuese të tij. Ndonëse denoncuesi është njohur me vendimin menjëherë pas marrjes së tij, nuk e ka kundërshtuar atë as në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor dhe as në Prokurorinë e Përgjithshme, çka tregon se atë kohë nuk ka pasur ndonjë pretendim.

218.5. Në thelb të kallëzimit të denoncuesit ka qenë fakti se pasuria e tij e vendosur si kolateral për llogari të një kredia të marrë nga një shtetas tjetër, ishte shitur nga përmbaruesi në një procedurë jo të rregullt ankandi dhe me çmime që janë dukshëm më të ulta se çmimet që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Në kallëzim pretendohet se kjo ishte një vjedhje që i bëhej pronës së tij dhe, për rrjedhojë, nga subjekti procedimi penal është regjistruar për veprën penale “vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, ashtu sikurse edhe kërkohet prej kallëzuesve.

218.6. Në bazë të kallëzimit të tij, denoncuesi kishte një shkresë të datës 17.10.2013, të ZVRPP-së Tiranë, e cila i kthente përgjigje avokatit S. D. për çmimet minimalë fiskalë të pasurisë në bazë të VKM-së nr. 187, datë 6.3.2013 dhe të Udhëzimit nr.1, datë 8.5.2013.

218.7. Sikurse vihet re nga aktet e procedimit, denoncuesi në cilësinë e paditësit i është drejtuar me një padi edhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor me objekt “anulimi i ankandit të zhvilluar në datën 12.10.2012, për shitjen e pasurisë së paluajtshme nr. ***, ndodhur në z. k. ***, e përbërë nga 288 m² truall dhe nga kjo ndërtesë 103 m²”. Me vendimin nr. ***, datë 13.2.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë, me argumentin se “*paditësi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit si ndaj veprimeve të mëparshme të përmbaruesit gjyqësor për caktimin e ekspertit, vlerësimin e sendit, por edhe ato të mëvonshme duke mos shfrytëzuar mundësitë ligjore të kontrollit të veprimeve të përmbaruesit brenda afatit ligjor*”.

219. Dy denoncimet e shtetasit E. S. regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 11.9.2018 dhe me nr. *** prot., datë 18.2.2019. Nga administrimi i dy denoncimeve, të cilat referojnë në procedime të hetuara nga një prokuror dhe nga subjekti i rivlerësimit, duket se denoncuesi ka kallëzuar penalisht shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k. me administrator A. L., si shkaktar të vdekjes së babait të tij. Z. S. S., për mosrespektim të kushteve ligjore në ndërtim dhe, për pasojë, është shkaktuar vdekja në vendin e punës.

219.1. Për subjektin e rivlerësimit, denoncuesi referon se e ka pushuar procedimin penal me nr. *** pa kryer veprimet procedurale, duke mos administruar procesverbalin e aksidentit në punë dhe duke argumentuar se firma ndërtuese kishte leje për prishje objekti, ndërkohë që sipas denoncuesit në dosje nuk figuron leje për prishje të objektit të ndërtimit. Subjekti ka paraqitur dokumentacion mbështetës shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2017, kthim përgjigjeje të lëshuar nga Bashkia Tiranë.

219.2. Në lidhje me procedimin penal nr. ***, nga vlerësimi i të cilit konstatohet se në datën 11.9.2014 është regjistruar procedimi penal për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Në vijim, në datën 20.10.2014, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.

219.3. Regjistrimi është bërë për të njëjtin fakt kriminal, bazuar mbi veprimet procedurale të kryera nga ana e Policisë Gjyqësore të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm Tiranë. Në këto rrethana ligjore, për shkak të regjistrimit të dy procedimeve për të njëjtin fakt penal me vendimin e datës 20.10.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur bashkimin e procedimeve penale me nr. ***, nr. *** dhe vazhdimin e hetimeve në një procedim penal të vetëm me nr. ***.

219.4. Nga administrimi i dosjes penale duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer disa veprime procedurale:

- nuk duket të jenë kryer veprime hetimore në kuadër të kallëzimit, datë 7.8.2014, për veprën penale “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, sipas nenit 301 të Kodit Penal;

- këqyrja e vendit të ngjarjes ka ndodhur shumë më vonë sesa aksidenti i kryer (të nesërmen e ngjarjes), ndërkohë që duket nga faktet që punonjësit e policisë ka qenë në dijeni të kësaj ngjarjeje, veprime të cilat duken se janë kryer për të lejuar ndryshimin e vendit dhe rrethanave të ngjarjes;
- nuk duket të jenë kryer veprime në drejtim të mbajtësit të ekskavatorit, i cili sipas kallëzuesit ka prishur godinën dhe që sipas kallëzuesit ka qenë i punësuar pa asnjë lloj kontrate dhe i palicencuar;
- shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka pasur leje për prishjen e objektit për godinën e banimit dhe shërbimit miratuar nga KKRT-ja nr. ***, Komuna ***, datë 29.9.2011, referuar shkresës nr. *** prot., datë 24.11.2017, paraqitur në cilësinë e provës nga denoncuesi.

Për sa më lart, iu kërkuan shpjegime subjektit lidhur me konstatimet e Komisionit në lidhje me këtë denoncim.

219.5. Lidhur me denoncimin e shtetasit E. S., subjekti ka shpjeguar se ndryshe nga sa pretendon denoncuesi që në vendim është argumentuar se firma e ndërtimit kishte leje për prishje të objektit të ndërtimit, realisht në vendim është thënë shprehimisht që: *“Brenda sheshit ku ishte miratuar dhe ndërtuar objekti i mësipërm, në jug të tij, ndodhej edhe një ndërtesë katërkatëshe, e cila komfort lejes së ndërtimit dhe sheshit të miratuar, duhej që të prishej, pasi binte pjesërisht në rrugë”*.

219.6. Në vijim, subjekti shpjegoi se hetimet në këtë procedim penal janë kryer kryesisht lidhur me veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, gjatë procesit të prishjes së ndërtesës katërkatëshe, por përveç kësaj pjesë e hetimit kanë qenë padyshim edhe gjithë veprimet e kryera nga momenti i njoftimit të ngjarjes në polici.

Ndonëse procedimi penal nuk është regjistruar në mënyrë të shprehur për veprën penale “veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, të gjitha veprimet hetimore të kryera nga subjekti pa dyshim që kanë pasur për synim edhe verifikimin e faktit nëse ndodheshim apo jo përpara kësaj vepre penale, si dhe verifikimin e çdo të dhëne që denoncuesi përmendte në kallëzimin e tij.

219.7. Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. ***, i është nënshtruar edhe kontrollit nga ana e gjykatës, pasi është ankimuar nga denoncuesi dhe pas debatit gjyqësor të zhvilluar, kërkesa e tij për prishjen e vendimit të prokurorit është rrëzuar me vendimin nr. *** akti, datë 28.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 3.6.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

219.8. Subjekti shpjegoi se vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, është verifikuar nga ana e gjykatave si më sipër dhe është lënë në fuqi prej tyre, duke konfirmuar në këtë mënyrë faktin që prej subjektit si prokuror janë kryer hetime të plota dhe shteruese, duke disponuar përfundim të tyre me një vendimmarrje të drejtë.

220. Pesë denoncimet e shtetasit T. R. regjistruar në Komision, respektivisht: nr. *** prot., datë 23.11.2018, i drejtuar ndaj subjektit dhe një tjetër prokurori; nr. *** prot., datë 8.4.2019; nr. *** prot., datë 12.6.2019; nr. *** prot., datë 9.4.2019; si dhe nr. *** prot., datë 18.4.2019.

220.1. Në denoncimet e përsëritura, denoncuesi referon, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime, ka keqinterpretuar provat që ka vënë në dispozicion personi i kallëzuar, si dhe ka manipuluar procesin hetimor. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion mbështetës, vendim mosfillim procedimi nr. ***. Komisioni e administroi këtë vendim, i cili është dhënë nga një prokuror tjetër, që është referuar në këtë denoncim nga denoncuesi.

220.2. Nga administrimi i dosjes mbi bazën e kallëzimit është nisur hetimi. Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet procedurale: ka këqyruar banesën e shtetasve R., ka administruar në cilësinë e provës materiale një sëpate me bisht druri, ka marrë në cilësinë e provës një CD me pamje filmike të regjistruara në ambientet e brendshme të dyqanit ku janë kryer veprimet, informacionin të nxjerrë nga regjistri elektronik i telefonatave *TIMS*, portal ku është telefonuar Komisariati nr.

***, lidhur me denoncimin që është kryer ndaj dy shtetasve me sëpate në dorë në datën 6.10.2018, ora 15:43, janë marrë të dhëna nga personi që ka dijani për veprën penale (nga kallëzuesi), si dhe nga shtetasja që ka qenë prezent në momentin e kërcënimit, janë marrë në pyetje T. dhe A. R. dhe në përfundim me njoftimin e datës 17.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar të pandehurit R. për akuzën, viktimën, si dhe iu ka njoftuar atyre lidhur me të drejtat ligjore procedurale, për të cilat kanë marrë dijani. Në vijim, me kërkesën për dërgim në gjyq, datë 28.12.2018, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve T. dhe A. R. akuzuar për veprën penale “kanosje” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 84 dhe 25 të Kodit Penal.

220.3. Gjithashtu, nga administrimi i denoncimit me nr. *** prot., datë 12.6.2019, denoncuesi denoncon se subjekti nuk ka deklaruar gjeneralitete të sakta, duke sqaruar se referuar numërorit telefonik të vitit 2006, i ati quhet A. Q. jo A. Q., si e ka deklaruar në formularin e dekriminalizimit.

220.4. Komisioni ka kërkuar të dhëna gjendjes civile për këtë denoncim, nga i cili kanë rezultuar faktet e referuara në komponentin e figurës mbi ndryshimin e mbiemrit të subjektit në vitin 1997. Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këto denoncime.

220.5. Lidhur me denoncimet e shtetasit T. R., subjekti ka shpjeguar se procedimi penal nr. ***, datë 23.10.2018, është filluar mbi bazën e materialit të referuar nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Nr.*** Tiranë, e cila kishte kryer veprimet e para procedurale si kontrolli i vendeve, administrimi i pamjeve filmike, sekuestrimi i një sëpatë, etj.

220.6. Hetimi i këtij procedimi penal është bërë me qëllim që të grumbullohej çdo e dhënë e mundshme që shërbente në dobi të zgjidhjes së çështjes, për vetë situatën konfliktuale që ekzistonte midis palëve (kallëzuesit dhe babait të denoncuesit).

220.7. Gjatë hetimit u bënë të gjithë përpjekjet (shihni edhe aktet që ndodhen në fashikull) për të identifikuar një shtetase (K. Rr.), e cila kishte qenë rastësisht e pranishme si kliente në dyqanin e kallëzuesit dhe për këtë shkak shpjegimet e saj vlerësoheshin me rëndësi për procesin. Deklarimet e saj krijuan përfundimisht bindjen se denoncuesi dhe babai i tij, duhej të akuzoheshin dhe të dërgoheshin për gjykim, për veprën penale “kanosje” parashikuar nga nenet 84 dhe 25 të Kodit Penal.

220.8. Pas shqyrtimit të kërkesës, gjyqtari i seancës ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim dhe në përfundim të gjykimit (i zhvilluar sipas rritit të gjykimit të shkurtuar) denoncuesi dhe babai i tij u deklaruan fajtor dhe u dënuan me vendimin nr. ***, datë 8.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (bashkëlidhur një kopje e vendimit). Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 23.5.2019, mbasi nuk është ankuar nga të pandehurit.

221. Denoncim i shtetasit R. T., regjistruar nr. *** prot., datë 1.12.2020, ndaj subjektit të rivlerësimit me objekt shkelje ligjore. Komisioni e administroi denoncimin nga ku konstatoi se denoncuesi ka referuar se në procedimin e nisur ndaj tij për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka shkelur dispozitat procedurale të parashikuar në nenin 327⁴⁰ të Kodit të Procedurës Penale.

221.1. Sipas denoncuesit, prokurori e ka njoftuar menjëherë për dërgimin e çështjes në gjyq pa respektuar dispozitat urdhëruese mbi njoftimin e përfundimit të hetimeve. Për sa më lart, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë denoncim.

221.2. Lidhur me denoncimet e shtetasit T. R., subjekti ka shpjeguar se ky person është marrë i pandehur për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit

⁴⁰ Neni 327 Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit

2. Brenda afatit të parashikuar nga neni 324, i këtij Kodi, prokurori njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehur, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit

4. I pandehuri njoftohet, gjithashtu, se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklaratime apo të kërkojë që të merret në pyetje. Kur i pandehuri kërkon të pyetet, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij.

Penal në dëm të viktimave E. T. dhe M. T., lindur dhe banues në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. I pandehuri gjatë hetimit ka dhënë disa herë shpjegime, duke u njohur rregullisht me aktet dhe nuk qëndron pretendimi i tij për mos respektimin e nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale.

221.3. Gjatë zhvillimit të seancës paraprake i pandehuri ka pasur mundësinë për të paraqitur kërkesat e tij dhe në përfundim të kësaj seance nga gjyqtari i çështjes mbasi janë shqyrtuar aktet e procedimit penal nr. ***, është vendosur dërgimi i çështjes për gjykim, ku edhe ndodhet aktualisht në fazën e shqyrtimit dhe marrjes së provave nga ana e prokurorit.

222. Komisioni, pasi analizoi denoncimet sipas ligjit nr. 84/2016, si dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti, vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, nuk ka kompetencë të gjykojë mbi themelin e çështjeve, tagra këto në kompetencë të një gjykate më të lartë.

KONKLUSIONI PËRFUNDIMTAR

Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, dëgjoi rekomandimin e relatores të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet dhe provat nga subjekti i rivlerësimit, si dhe mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, arrin në përfundimin se:

a) Subjekti ka mungesë së burimeve financiare duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, gërma “b”, të ligjit nr. 84/2016.

b) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurive duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, gërma “a”, të ligjit nr. 84/2016.

c) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të figurës duke u ndodhur në kushtet e pikës 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

d) Në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit z.Genci Qana ka dështuar në kontrollin e pasurisë dhe figurës ku rezulton se ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61/3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Genci Qana, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 31.3.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku